

VENDIM
Nr. 3, datë 15.1.2026

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Marsida Xhaferllari,	kryesuese;
Fiona Papajorgji,	anëtare;
Sonila Bejtja,	anëtare;
Sandër Beci,	anëtar;
Ilir Toska,	anëtar;
Genti Ibrahimimi,	anëtar;
Asim Vokshi,	anëtar;
Marjana Semini	anëtare,

me sekretare Anjeza Puka, në datën 17.12.2025 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 15 (S) 2025 të Regjistrat Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Sali Berisha, përfaqësuar nga avokate Klodiana Gjyzari, me prokurë të posaçme.

SUBJEKT I INTERESUAR

Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, përfaqësuar nga prokurori Arben Kraja.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 400, datë 30.7.2024, të Gjykatës së Posaçme së Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 172 (87-2024-248), datë 13.9.2024, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 00-2024-2076, datë 17.12.2024, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Detyrimi i Ministrisë së Financave të rimbursojë shpenzimet e kryera deri në masën 200.000 lekë.

BAZA LIGJORE: Nenet 15, 17, 18, 27, 28, 42, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 5, pika 1, shkronjat “b” dhe “c”, 8, 10, 14, 17 dhe 18 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); nenet 9, 14 dhe 26 të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, të ratifikuar me ligjin nr. 7510, datë 8.8.1991, “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike”; nenet 27 dhe 71/a të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Marjana Semini, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuarit Sali Berisha (*kërkuesi*), i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (*Prokuroria e Posaçme*), që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi është aktualisht politikan, drejtues i partisë kryesore opozitare dhe deputet i Kuvendit, si dhe ish-president dhe ish-kryeministër. Mbi bazën e një kallëzimi për kryerjen e

disa veprave penale nga funksionarë të lartë shtetërorë, të bërë nga shtetasi T.B., i cili në atë kohë ka qenë kryetari i grupit parlamentar të partisë në pushtet, Prokuroria e Posaçme në vitin 2020 ka regjistruar procedimin penal nr. 287 (*procedimi penal nr. 287/2020*) për veprën penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, të parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal (KP). Objekti i kallëzimit dhe i hetimit në vijim lidhet me procesin e kthimit të pronës në favor të 5 familjeve ish-pronare, procesin e privatizimit të pronës shtetërore (të objekteve të ish-klubit sportiv “Partizani”), procesin e ndryshimit të destinacionit dhe, më pas, edhe të zhvillimit të pronës.

2. Me urdhrin e datës 2.10.2023, prokurorët e çështjes kanë shënuar në regjistrin e njoftimit të veprave penale edhe emrin e kërkuesit, si të dyshuar për kryerjen e veprës penale “Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë”, në bashkëpunim me shtetasit J.M. dhe F.B., të parashikuar nga nenet 260 e 25 të KP-së. Për sa i përket kërkuesit, faktet penale objekt hetimi lidhen me sjelljen e dyshuar të tij gjatë kohës kur ai ka ushtruar funksionin e Kryeministrit, pas vitit 2005, në proceset e kthimit të pronës, të privatizimit të pronës shtetërore (objekteve të ish-klubit sportiv “Partizani” në varësi të Ministrisë së Mbrojtjes dhe të klubit shumësportesh “Partizani” në varësi të Ministrisë së Kulturës), si dhe të ndryshimit të destinacionit e të zhvillimit të pronës, duke favorizuar shtetasit J.M., F.B. e XH.B., ku këta të fundit dhe shoqëria e lidhur me ta kanë realizuar ndërtimin e një blloku pallatesh. Për këto procese dyshohet se janë dhënë dhe marrë përfitime monetare, paligjshmëria në origjinën e të cilave është fshehur nëpërmjet veprimeve financiare, transaksioneve të copëzuara ose në *cash*.

i. Procesi i parë

3. Në datën 16.10.2023 Prokuroria e Posaçme ka paraqitur në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (GJKKO-ja e Shkallës së Parë) kërkesën për caktimin e masave të sigurimit personal ndaj personave nën hetim, përfshirë edhe kërkuesin, për të cilin është kërkuar vendosja e masave të sigurimit personal “*Detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore*” dhe “*Ndalimi i daljes jashtë shtetit*”, të parashikuara nga nenet 234 dhe 233 të Kodit të Procedurës Penale (KPP).

4. Mbi kërkesën e Prokurorisë së Posaçme, GJKKO-ja e Shkallës së Parë, gjyqtari i hetimeve paraprake, me vendimin nr. 112, datë 20.10.2023 (*vendimi nr. 112/2023*), ka vendosur të pranojë kërkesën e Prokurorisë së Posaçme, duke caktuar për kërkuesin masat e sigurimit personal “*Detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore*” dhe “*Ndalimi i daljes jashtë shtetit*”. Me vendimin nr. 117, datë 26.10.2023 (*vendimi nr. 117/2023*), GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka disponuar me vazhdimin e këtyre masave. Ky vendim është miratuar nga Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (GJKKO-ja e Apelit) me vendimin nr. 56 (87-2023-156), datë 21.11.2023, ndërsa Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-384, datë 5.3.2024, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuesi. Ky proces gjyqësor është bërë objekt kontrolli nga Gjykata Kushtetuese (Gjykata), e cila, me vendimin nr. 81, datë 21.11.2024 (*vendimi nr. 81/2024*), ka vendosur pranimin pjesërisht të kërkesës dhe shfuqizimin e këtyre vendimeve gjyqësore, si të papajtueshme me Kushtetutën, vetëm për pjesën që kanë caktuar masën e sigurimit personal “*Ndalimi i daljes jashtë shtetit*” ndaj kërkuesit Sali Berisha.

ii. Procesi i dytë

5. Ndërkohë, duke qenë se kërkuesi nuk ka respektuar një prej detyrimeve të vendosura me vendimin nr. 112/2023 të GJKKO-së së Shkallës së Parë, të konfirmuar me vendimin nr. 117/2023 të kësaj të fundit, konkretisht “*Detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore*”, Prokuroria e Posaçme i ka kërkuar Kuvendit dhënien e autorizimit për arrestimin/heqjen e lirisë së tij për zëvendësimin e masave të sigurimit personal nga “*Detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore*” dhe “*Ndalimi i daljes jashtë shtetit*”, në atë “*Arresti në burg/shtëpi*”, të parashikuara nga nenet 237 dhe 238 të KPP-së.

6. Mbi bazën e rekomandimit të Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin, Kuvendi, i mbledhur në seancë plenare në datën 21.12.2023, me vendimin nr. 127, datë 21.12.2023, ka vendosur pranimin e kërkesës së Prokurorisë së Posaçme për dhënien e autorizimit për arrestimin/heqjen e lirisë së kërkuesit nëpërmjet zëvendësimit të masës së sigurimit. Në datën 22.12.2023 Prokuroria e Posaçme ka paraqitur pranë GJKKO-së së Shkallës së Parë (gjyqtarit të hetimeve paraprake) kërkesën për zëvendësimin e masës së sigurimit personal ndaj kërkuesit, e cila është pranuar me vendimin nr. 520, datë 30.12.2023 të asaj gjykate (*vendimi nr. 520/2023*), duke u caktuar ndaj kërkuesit masa e sigurimit “Arresti në shtëpi”. Ky vendim është miratuar nga GJKKO-ja e Apelit me vendimin nr. 15 (87-2024-23), datë 25.1.2024, i cili është lënë në fuqi nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë me vendimin nr. 00-2024-667 (94), datë 9.4.2024. Edhe ky proces gjyqësor është bërë objekt i kontrollit kushtetues nga Gjykata, e cila, me vendimin nr. 1, datë 17.1.2025 (*vendimi nr. 1/2025*), ka vendosur rrëzimin e kërkesës.

7. Ndërkohë që procesi i dytë ishte në shqyrtim pranë Gjykatës, GJKKO-ja e Shkallës së Parë, me vendimin nr. 674, datë 27.11.2024 (*vendimi nr. 674/2024*), ka vendosur pranimin e kërkesës së kërkuesit dhe revokimin e masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues “Arresti në shtëpi”, për shkak se nuk ekzistojnë më nevojat e sigurimit. Në vijim, mbi ankimin e Prokurorisë së Posaçme, GJKKO-ja e Apelit, në datën 3.1.2025, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. 674/2024 të GJKKO-së së Shkallës së Parë dhe zëvendësimin e masës së sigurimit “Arresti në shtëpi” me masën e sigurimit “Detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”.

iii. Procesi i tretë

8. Në datën 28.6.2024 Prokuroria e Posaçme, bazuar në nenin 246, pika 6, të KPP-së, ka paraqitur pranë GJKKO-së së Shkallës së Parë informacionin me shkrim, si dhe provat e përfuara në kuadër të hetimit dymujor për kërkuesin, i cili i referohet periudhës dymujore para kësaj date, ku i kërkon asaj gjykate vijimin e zbatimit të masës së sigurimit personal “Arresti në shtëpi”, duke argumentuar se vijnë të ekzistojnë kushtet dhe kriteret e vlerësuara për caktimin e masave të sigurimit, konkretisht ekziston dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova për kryerjen e veprës penale dhe dyshimi për kryerjen e saj rëndon mbi kërkuesin. Ndërsa kërkuesi, në parashtrimet e paraqitura nëpërmjet mbrojtësve të tij, i ka kërkuar GJKKO-së së Shkallës së Parë revokimin e masës së sigurimit “Arresti në shtëpi”, të caktuar me vendimin nr. 520/2023 të asaj gjykate, duke argumentuar se nuk ekzistojnë kushtet dhe kriteret për caktimin e saj dhe se nevojat e hetimit nuk e diktojnë vazhdimin e masës së sigurimit.

9. GJKKO-ja e Shkallës së Parë, me vendimin nr. 400, datë 30.7.2024 (*vendimi nr. 400/2024*), ka vendosur vijimin e zbatimit të masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues “Arresti në shtëpi”, të caktuar ndaj kërkuesit me vendimin nr. 520/2023 të asaj gjykate. Sipas GJKKO-së së Shkallës së Parë, nevojat e sigurimit në ngarkim të kërkuesit, lidhur me rrezikun e dëmtimit të provave, janë të tilla që justifikojnë vijimin e zbatimit të masës së sigurimit “Arresti në shtëpi”. Po sipas asaj gjykate, vijon të ekzistojë mundësia që ai të ndërhyjë dhe të ndikojë në prishjen ose asgjësimin e provave dhe rreziku i largimit të tij vazhdon të jetë ende prezent. Ndaj këtij vendimi ka bërë ankim kërkuesi.

10. GJKKO-ja e Apelit, me vendimin nr. 172 (87-2024-248), datë 13.9.2024, ka vendosur miratimin e vendimit nr. 400/2024 të GJKKO-së së Shkallës së Parë. Sipas GJKKO-së së Apelit, vendimmarrja e GJKKO-së së Shkallës së Parë është e drejtë dhe nevojat e sigurimit mbeten të pandryshuara ose të qëndrueshme, njësoj si në kohën e caktimit të masave të sigurimit, pasi nuk kanë ndryshuar rrethanat për të cilat janë vendosur ato. Po sipas GJKKO-së së Apelit, ekziston frika dhe rreziku që lënia në liri e kërkuesit mund të cenojë procesin e mbledhjes dhe vërtetësisë së provave dhe për t’iu shmangur procedimit, rreziqe të cilat konstatohet se janë konkrete dhe aktualisht prezente si në gjenezën e caktimit të masës së sigurimit personal ndaj tij. Po ashtu, GJKKO-ja e Apelit ka arsyetuar se rreziku i ikjes së

kërkuesit për t'iu shmangur drejtësisë është i qëndrueshëm dhe aktual. Ndaj këtij vendimi ka paraqitur rekurs kërkuesi.

11. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-2076, datë 17.12.2024, ka vendosur mospranimin e rekursit, për shkak se nuk përmbante asnjë nga shkaqet e parashikuara nga neni 432 i KPP-së. Sipas Kolegjit Penal, gjykatat më të ulëta kanë argumentuar vendimmarrjet e tyre dhe u kanë dhënë përgjigje në thelb shkaqeve të parashtruara nga kërkuesi dhe arsyetimet e tyre janë plotësuese të njëra-tjetrës. Po sipas Kolegjit Penal, të dyja gjykatat kanë argumentuar mjaftueshëm edhe ligjshmërinë e vazhdimit të zbatimit të masave të sigurimit personal ndaj të hetuarve, si dhe kanë analizuar kushtet dhe kriteret e parashikuara në ligj për caktimin e masave të sigurimit personal.

12. Në datën 11.6.2025 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij (duke kundërshtuar vendimet gjyqësore të procesit të tretë), i cili është regjistruar në të njëjtën datë.

13. Kolegji i Gjykatës në datën 29.7.2025 ka vendosur kalimin e kërkesës për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve, e cila në datën 12.9.2025 ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

14. Me vendimin e datës 4.12.2025, Mbledhja e Gjyqtarëve ka vendosur rrëzimin e kërkesës se një gjyqtari për heqjen dorë nga shqyrtimi i kësaj çështjeje, duke vlerësuar se nuk ekzistojnë pengesat ligjore të parashikuara nga neni 36, pika 1, shkronja “ç”, i Ligjit Organik dhe neni 18 pika 1, shkronja “ç”, i Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

15. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, në ankimin kushtetues individual dhe parashtrimet e tij ka pretenduar se i është cenuar:

15.1. *Për aspektin procedural - E drejta për proces të rregullt në drejtim të:*

15.1.1. *Së drejtës për t'iu gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj*, pasi gjyqtarja I.Gj., që ka dhënë vendimin në shkallë të parë, është dënuar me burgim për kryerjen e veprës penale “Falsifikimi i pasaportave, vizave”, dënim i cili më pas i është konvertuar me gjobë. Referuar dispozitave ligjore në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar (ligji nr. 96/2016), gjyqtari i cili në kohën e hyrjes në fuqi të këtij ligji rezultonte i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë humbiste mandatin e magjistratit, bazuar në nenet 28, shkronja “d”, 64 dhe 66 të këtij ligji. Kërkuesi ka marrë dijeni për provat që mbështesin këtë pretendim në datën 5.5.2025 dhe në seancën gjyqësore paraprake të së njëjtës datë (5.5.2025) ka kërkuar kohë për paraqitjen e kërkesës për pavlefshmërinë e vendimit nr. 400/2024 të GJKKO-së së Shkallës së Parë. Po ashtu, për të njëjtën arsye, kërkuesi i është drejtuar edhe Këshillit të Lartë Gjyqësor (KLGJ) me kërkesë për mbarimin e mandatit të magjistratit të gjyqtarës I.Gj. Kjo kërkesë e kërkuesit është lënë pa përgjigje nga KLGJ-ja. Në funksion të argumentit se gjyqtarja I.Gj. nuk plotëson kriteret për të kryer detyrën e magjistrates për shkak të dënimit të saj të mëparshëm, kërkuesi parashtron se Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) në çështjen *Canj kundër Shqipërisë* ka interpretuar pikërisht nenet 28 dhe 66 të ligjit nr. 96/2016, të cilat parashikojnë kriteret për t'iu emëruar si magjistrat, si dhe rastet e pazgjedhshmërisë dhe të papajtueshmërisë. Gjyqtarja I.Gj. nuk ka përmbushur detyrën që prej hyrjes në fuqi të ligjit nr. 96/2016, po ashtu as KLGJ-ja nuk ka përmbushur detyrën e saj.

15.1.2. *Parimit të paanshmërisë në dy drejtime: Së pari*, pasi gjyqtarja I.Gj., gjyqtare e hetimit paraprak pranë GJKKO-së së Shkallës së Parë, kur kërkesa për revokimin e masës së sigurimit është paraqitur nga kërkuesi, nuk ka zbatuar afatet procedurale të parashikuara nga

ligji. Ajo gjyqtare ka bërë një trajtim të ndryshëm të kërkesave të paraqitura nga kërkuesi në raport me kërkesat e paraqitura nga organi i akuzës, ndërkohë që në të dyja rastet mosrespektimi i afateve procedurale nuk shoqërohet me ndonjë pasojë. Njëanshmëria e gjyqtarës së hetimit paraprak është perceptuar nga kërkuesi nisur nga sjellja e saj. E njëjta gjyqtare ka vlerësuar më parë, me vendimin nr. 117/2023 të GJKKO-së së Shkallës së Parë, se afati prej dy ditësh është i mjaftueshëm për mbrojtësit e kërkuesit që të njihen me 42 fashikuj dhe një vendim gjyqësor prej 200 faqesh. Ndërkohë, organit të akuzës i ka dhënë 11 ditë kohë për të lexuar një material prej jo më shumë se 50 faqesh, të relatuar nga mbrojtësit e kërkuesit në seancë, i cili ishte mbështetur në informacionin e vet organit të akuzës. Janë disa vendime të ndërmjetme të gjyqtarës I.Gj. të cilat dëshmojnë se opinioni i saj juridik ndryshon sipas opinionit juridik të organit të akuzës. Me sjelljen e saj gjyqtarja e hetimit paraprak e ka vendosur kërkuesin në pozita procedurale jo të barabarta me organin e akuzës. *Së dyti*, për shkak të dispozitave të ligjit nr. 95/2016, datë 6.10.2016, “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar” (ligji nr. 95/2016), pasi prokurorët dhe gjyqtarët e gjykatave të posaçme janë nën vëzhgimin e një oficeri hetues. Në këtë kuptim, gjyqtarët e gjykatave të posaçme janë objekt i një monitorimi që nuk paraqet asnjë garanci ligjore dhe institucionale.

15.1.3. *Së drejtës së aksesit dhe standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor*, pasi gjykatat nuk i kanë dhënë përgjigje kërkuesit në lidhje me pretendimet e ngritura prej tij për cenimin e të drejtave dhe lirive themelore. Gjykatat nuk kanë marrë në shqyrtim pretendimin e kërkuesit për revokimin e masës së sigurimit “Arresti në shtëpi” dhe argumenti i dhënë prej tyre se ky pretendim ishte shqyrtuar në vendimmarrje të mëparshme nuk është i vërtetë. Gjykatat kanë arsyetuar se nevojat e hetimit nuk kanë ndryshuar, por nuk janë ndalur në mënyrë të posaçme në ndonjë element konkret që kishte rezultuar nga hetimi. Arsyetimet e gjykatave janë kontradiktore dhe të pakuptueshme. Gjykatat në arsyetimin e tyre kanë përdorur fraza standarde dhe arsyetime të cilat janë përdorur prej tyre edhe më parë. Në lidhje me rrezikun e ikjes së kërkuesit, gjykatat kanë dhënë të njëjtat argumente që kanë dhënë kur kanë caktuar masat e para të sigurimit personal “Detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore” dhe “Ndalimi i daljes jashtë shtetit”. Ato nuk kanë arsyetuar pse është i pabazuar kërkimi i kërkuesit për detyrimin e gjykatës që të verifikojë diligjencën e duhur të organit të akuzës. Nuk ka asnjë të dhënë për evidentimin e ndonjë rreziku që kërkuesi të ndikonte mbi provat.

15.2. *Për aspektin substancial – cenimi i lirisë personale në drejtim të:*

15.2.1. *Mungesës së faktit penal*, në shkellje të nenit 27, pika 2, shkronja “c”, të Kushtetutës, pasi gjykatat nuk mund të lejojnë dhe të arsyetojnë se pas katër vjetësh hetime Prokuroria e Posaçme mund të paraqitet në gjykatë dhe të mbështesë dyshimin për kryerjen prej kërkuesit të faktit penal përsëri në të njëjtat arsye, miratimit të akteve kolegjiale. Pas katër vjetësh nga hetimi Prokuroria e Posaçme duhet të argumentojë mjaftueshëm pse pjesëmarrja në akte kolegjiale në mënyrë të arsyeshme të çon në konkluzionin se mund të përbëjë fakt penal. Gjykatat pas katër vjetësh hetime duhet të argumentonin mjaftueshëm sesi kërkuesi në cilësinë e ish-Kryeministrit duhet të parashikonte që propozimi i Këshillit të Ministrave për miratimin e ligjeve në Kuvend, miratimi po prej Këshillit të Ministrave i akteve të tjera normative ose i akteve të tjera në të cilat nuk ka përcaktime për një marrëdhënie juridike konkrete, të veçantë, do të sillte përfitime shumë vite më vonë. Gjykata në vendimin e saj nr. 1/2025 ka vlerësuar, se: “qenia e kërkuesit në cilësinë e kryetarit të një organi kolegjial, i cili ka disponuar për lirimin nga detyra të gjyqtarës, nuk është shkak për të vënë në dyshim paanshmërinë e gjyqtarës, për sa kohë nuk rezulton dhe nuk është provuar që ai (kërkuesi), në cilësinë e kryetarit të atij organi, të ketë pasur votë përcaktuese në këtë drejtim ose të ketë vënë në lëvizje procedimin disiplinor ndaj gjyqtarës, ose të ketë pasur ndonjë rol përcaktues në procedimin disiplinor ndaj saj”. I njëjti kriter i vendosur nga Gjykata duhej të mbahej parasysh edhe nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm.

15.2.2. *Mungesës së shkakut ligjor* për moszbatimin e urdhrave të ligjshëm të gjykatës, për shkak të mosekzistencës së shkakut procedural për të cilin është kërkuar zëvendësimi i masës së sigurimit personal, pasi vendimi gjyqësor mbi bazën e të cilit ishin caktuar masat e sigurimit personal nuk ka qenë i ekzekutueshëm deri në datën 21.11.2023, kur ka marrë formë të prerë. Në datat që prokuroria pretendon se kërkuesi duhej të paraqitej në Policinë Gjyqësore, vendimi gjyqësor që ka vendosur këtë detyrim nuk ka qenë i ekzekutueshëm, pasi ndaj tij ishte bërë ankim. Në rastin e zëvendësimit të masave të sigurimit personal të vendosura ndaj kërkuesit, gjykatat nuk kanë hetuar kur ka lindur detyrimi i tij për zbatimin e masave të sigurimit të caktuara me vendimin nr. 112/2023. Arsyeimi i gjykatave se detyrimi për zbatimin e masave të sigurimit personal të vendosura me vendimin nr. 112/2023 ka lindur menjëherë me shpalljen e vendimit është i gabuar dhe në shkelje të nenit 417 të KPP-së.

15.2.3. *Standardit të arsyesimit të vendimeve gjyqësore*, pasi gjykatat nuk kanë dhënë argumente të mjaftueshme për nevojën e kohëzgjatjes së masës së sigurimit personal “Arresti në shtëpi”; për vazhdimin e kufizimit të lirisë personale dhe të së drejtës për jetë familjare; për cenimin e lirisë së shprehjes; për cenimin e së drejtës së organizimit dhe së drejtës për të ushtruar mandatin e deputetit. Gjykatat nuk kanë arsyetuar domosdoshmërinë e vazhdimin të masës së sigurimit personal “Arresti në shtëpi”. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë nuk e ka arsyetuar vendimin e tij, por ka adaptuar arsyetimet e gjykatave më të ulëta, duke i vlerësuar komplementare të njëra-tjetrës. Gjykatat nuk e kanë mbështetur arsyetimin e tyre në të dhënat që kanë rezultuar nga hetimi, pasi nuk rezulton që gjatë kohës që janë zhvilluar hetimet të jetë evidentuar ndonjë e dhënë nga e cila të rezultonte përpjekja e kërkuesit për të ndikuar procesin e marrjes së provave. Arsyeimi i gjykatave është në kundërshtim me qëndrimin e organit të akuzës, sipas të cilit nuk ekziston rreziku i ikjes së kërkuesit. Konstatimet gjyqësore në vendimet e caktimit të masave të sigurimit personal nuk mund të përbëjnë “gjë të gjykuar”. Prokuroria e Posaçme në rastin konkret ka ndryshuar qëndrim nga ai i mbajtur në aktet fillestare për caktimin e masës së sigurimit.

15.2.4. *Parimit të mosdiskriminimit*, pasi në vendimin e GJKKO-së së Apelit nuk gjejnë pasqyrim pretendimet e ngritura nga i bashkakuzuari tjetër, në lidhje me pretendimin për “përndjekje politike”. Kërkuesi dhe subjektet e tjera të këtij procedimi nuk janë lejuar nga gjykatat të paraqesin në seancë pretendimet e tyre për motivin politik të procedimit penal. Në këtë rast, gjykatat kanë tejkaluar kufizimet e parashikuara nga KEDNJ-ja, e cila ka epërsi ndaj së drejtës së brendshme dhe zbatohet drejtpërdrejt. Qëllimi real i izolimit të kërkuesit ka qenë pengimi i ushtrimit të të drejtave të tij politike, si liria e shprehjes, liria e organizimit, si dhe ajo e përfaqësimit të zgjedhësve dhe provat për këtë janë vetë sjellja e autoriteteve shtetërore. Kërkuesi është kryetari i partisë opozitare me numrin më të lartë të deputetëve në Kuvend. Procedimi penal ka nisur nga kallëzimi i kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, parti e cila ka numrin më të lartë të deputetëve në Kuvend. Po ashtu, Kryeministri i vendit është shprehur në kongresin e Partisë Socialiste se reforma në drejtësi ka dështuar në rast se Prokuroria e Posaçme nuk heton kërkuesin.

15.2.5. *Parimit të barazisë përpara ligjit*, pasi gjykatat mbajnë standard të dyfishtë për kërkuesin, në krahasim me shtetas të tjerë. Sipas gjykatave, vepra penale është kryer nga kërkuesi, si në rastin kur ka qenë në rolin e përfaqësuesit të organit propozues të akteve ligjore, ashtu edhe në rastet kur ka qenë në rolin e drejtuesit të organit që ka shqyrtuar propozimin e një subjekti tjetër. Ndërkohë, Gjykata e ka trajtuar ndryshe rolin e kërkuesit si kryetar i ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë, në marrjen pjesë dhe vendimmarrjen për akte kolegjiale individuale, me rolin e tij në marrjen pjesë dhe vendimmarrjet për akte kolegjiale normative. Gjykatat nuk kanë dhënë argumente të mjaftueshme për të provuar se kërkuesi nuk po ndiqet penalisht për motive politike.

16. **Subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme**, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar si vijon:

16.1. *Për aspektin procedural*

16.1.1. Pretendimet e kërkuarit për cenimin e parimit të paanshmërisë dhe së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj janë të pabazuara, pasi vendimi i GJEDNJ-së, i referuar prej tij, pasqyron procesin ligjor të gjykatave vendase në rastin e gjyqtarit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit L.D., që përfundoi me vendimin e Komisionit Disiplinor sipas parashikimit të nenit 128, pika 2, shkronja "b", të Kushtetutës, ndaj rrethana e pretenduar nga kërkuari kërkon rit të ndryshëm dhe është jashtë kufijve të shqyrtimit të këtij gjykimi kushtetues. Këto pretendime janë ngritur edhe në një gjykim tjetër të zhvilluar nga Gjykata, e cila, me vendimin nr. 42, datë 1.7.2025, ka arsyetuar se nuk ka ndonjë akt të organit publik të ngarkuar nga ligji që të ketë vendosur për ndalimin e ushtrimit të funksionit nga gjyqtarja I.Gj. për shkakun e pretenduar. Në këtë kuptim, ajo gjyqtare, ndërsa ka qenë në detyrë, ka vepruar në kushte legjitimiteti në ushtrimin e funksioneve në rastin konkret.

16.2. *Për aspektin substancial*

16.2.1. Pretendimet e kërkuarit për cenimin e të drejtave substanciale janë të pabazuara, pasi bazuar në arsyetimin e vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, ndërlidhet qartë statusi i gjësë së gjykuar, për sa kohë nuk janë verifikuar/konstatuar ndryshimet e kushteve origjinare të zbatueshmërisë së masës së caktuar. Në rastin konkret, nga gjykatat e të gjitha shkallëve është respektuar kriteri kushtetues i dyshimit të arsyeshëm, si kusht *sine qua non* për justifikimin e kufizimit të lirisë personale të kërkuarit. Po ashtu, nga gjykatat është arsyetuar mjaftueshëm në lidhje me plotësimin e kushteve të veçanta për caktimin e masës së sigurimit, rrezikut të ikjes së personit dhe rrezikut të ndërhyrjes së tij në marrjen e provave.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. *Për legjitimitimin e kërkuarit*

17. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, si edhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

18. Në lidhje me legjitimitimin *ratione personae*, Gjykata konstaton se objekt i këtij ankimi kushtetues individual janë vendimet gjyqësore të të tria shkallëve të gjyimit që kanë vendosur vijimin e zbatimit të masës së sigurimit personal "Arresti në shtëpi". Gjykata vëren se në momentin e paraqitjes së ankimit kushtetues individual (11.6.2025) kërkuari nuk ishte më nën masën e sigurimit "Arresti në shtëpi", pasi përfundimisht prej datës 3.1.2025 gjykatat e zakonshme kanë vendosur zëvendësimin e saj me masën e sigurimit "Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore". Megjithatë, kërkuari e mbart ende statusin e viktimës, për shkak se gjykatat e zakonshme në rastin e ndryshimit të masës së sigurimit ndaj tij nuk e kanë njohur/korrigjuar shkeljen e së drejtës që pretendohet se është shkelur. Sikurse ka pohuar edhe Gjykata në vendimmarrjen e saj, ndryshimi i nevojave të sigurimit, për pasojë vendimet gjyqësore që ndryshojnë masat e sigurimit *in melius*, nuk mund të konsiderohen si korrigjime të shkeljes së pretenduar (*shih vendimin nr. 1, datë 17.1.2025, të Gjykatës Kushtetuese*). Pra, pavarësisht se masa e sigurimit "Arresti në shtëpi" e kundërshtuar nga kërkuari nuk është më në fuqi për shkak të ndryshimit të saj dhe, për rrjedhojë, vendimet objekt kërkesë nuk sjellin

më pasoja ndaj tij, kjo nuk ndryshon faktin se kërkuesi ka vuajtur një masë heqjeje të lirisë, për të cilën ai pretendon se është jokushtetuese dhe ka cenuar liritë dhe të drejtat e tij. Në këto kushte, Gjykata vlerëson se kërkuesi legjitimohet *ratione personae* si në aspektin procedural, ashtu edhe atë substancial, pasi jo vetëm ka qenë palë në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, por provon edhe interesin e drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi kushtetues.

19. Për sa i takon kriterit të *shterimit të mjeteve juridike efektive*, individit mund t'i drejtohet Gjykatës me ankim kushtetues individual, vetëm pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që ai pretendon se i janë cenuar. Detyrimin për përmbushjen e këtij kriteri Gjykata e ka vlerësuar si në rastet e vendimeve përfundimtare, që kanë përmbyllur në themel procesin gjyqësor, ashtu edhe në rastin e vendimeve të ndërmjetme, karakteri i të cilave është konsideruar përfundimtar për qëllimet e nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës. Për sa u takon këtyre të fundit, Gjykata ka pranuar se vendimet gjyqësore për caktimin e masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues që lidhet me heqjen e lirisë së individit, si përjashtim, i bëjnë ato vendime përfundimtare në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 19, datë 4.4.2023; nr. 14, datë 11.3.2021; nr. 28, datë 23.6.2011, të Gjykatës Kushtetuese*). Si të tilla, Gjykata në jurisprudencën e saj ka konsideruar si masat e sigurimit personal “Arresti në burg” (*shih vendimet nr. 83, datë 5.12.2024; nr. 40, datë 14.5.2024; nr. 28, datë 23.6.2011, të Gjykatës Kushtetuese*), ashtu edhe “Arresti në shtëpi” (*shih vendimet nr. 17, datë 13.3.2024; nr. 75, datë 22.12.2015, të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata, gjithashtu, ka marrë në shqyrtim edhe vendimet gjyqësore të dhëna në lidhje me kërkesat për zëvendësimin e masave të sigurimit (*shih vendimin nr. 40, datë 14.5.2024, të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Në rastin konkret, Gjykata vëren se objekt i ankimit kushtetues individual janë vendimet gjyqësore që kanë vlerësuar informacionin dymujor të Prokurorisë së Posaçme në kuadër të procedimit penal nr. 287/2020 ndaj kërkuesit, bazuar në nenin 246, pika 6, të KPP-së, i cili parashikon se çdo dy muaj nga zbatimi i vendimit të arrestit, prokurori informon me shkrim gjykatën që ka caktuar masën për hetimet e kryera dhe nevojat e sigurimit dhe gjykata, pasi dëgjon palët, vendos vazhdimin, zëvendësimin ose revokimin e masës së sigurimit. Për shkak të natyrës së ndërmjetme, jo përfundimtare, të këtyre vendimeve, si dhe periodicitetit të tyre, për sa kohë që ato janë dhënë në kuadër të një procedimi penal që është ende duke u zhvilluar, do të analizohet në vijim, sipas jurisprudencës kushtetuese, nëse përjashtimisht ato mund të konsiderohen përfundimtare për ushtrimin e kontrollit kushtetues ndaj tyre.

21. Për sa më lart, Gjykata konstaton se vendimet gjyqësore të kundërshtuara nëpërmjet këtij ankimi kushtetues individual, për sa kohë kanë disponuar për vijimin e zbatimit të masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues “Arresti në shtëpi”, pra në thelb për zgjatjen e saj, rezultojnë të kenë vendosur kufizime mbi të drejtat e kërkuesit të pretenduara të cenuara (*liria personale*), të cilat janë pasojë e drejtpërdrejtë e këtyre vendimeve. Gjithashtu, kërkuesi i ka kundërshtuar vendimet në fjalë në të gjitha shkallët e gjyqimit dhe ato kanë një masë autonomie nga procesi i themelit, pasi vendimi përfundimtar nuk mund të riparojë efektin e tyre. Për rrjedhojë, pavarësisht faktit se këto vendime gjyqësore kanë natyrë periodike, pasi dalin bazuar në detyrimin e prokurorit për të informuar çdo dy muaj gjykatën për hetimet e kryera dhe nevojat e sigurimit, Gjykata çmon se ato konsiderohen përfundimtare në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës dhe nenit 71/a, pika 1, shkronja “a”, të Ligjit Organik të Gjykatës. Në këtë kuptim, kërkuesi ka shteruar formalisht mundësitë e ofruara nga sistemi i apelineve, duke ngritur në substancë pretendimet e tij.

22. Po në lidhje me *shterimin e mjeteve juridike efektive*, në drejtim të pretendimeve të ngritura në ankimin kushtetues individual, Gjykata ka theksuar se ky kriter kërkon që pretendimet që parashtrihen përpara kësaj Gjykate të jenë paraqitur më parë në gjykatat e zakonshme, të paktën në substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara

në ligjin procedural (*shih vendimet nr. 5, datë 9.2.2023; nr. 12, datë 9.3.2021; nr. 8, datë 19.3.2018, të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Në rastin në shqyrtim, Gjykata vëren se për sa i përket aspektit substancial të kriterit të shterimit të mjeteve juridike efektive, kërkuesi, ndër të tjera, ka pretenduar cenimin e *parimit të mosdiskriminimit* dhe *barazisë përpara ligjit* të lidhur me tejkalimin e qëllimeve për të cilat lejohen kufizimet e të drejtave dhe nenin 18 të KEDNJ-së, me argumentin se ndjekja penale është shtyrë nga motive politike dhe se gjykatat në rastin e tij kanë mbajtur standard të dyfishtë në krahasim me shtetas të tjerë. Në lidhje me këto pretendime, referuar kërkesës dhe materialeve të ardhura me të, Gjykata konstaton se kërkuesi nuk i ka ngritur ato në rekursin e paraqitur në Gjykatën e Lartë. Për këtë arsye ai nuk ka shteruar mjetet juridike efektive në aspektin substancial për këto pretendime, ndaj ato nuk mund të merren në shqyrtim nga Gjykata. Për më tepër, Gjykata konstaton se kërkuesi nuk ka paraqitur argumente të mjaftueshme kushtetuese për këto pretendime.

24. Kërkuesi legjitimohet *ratione temporis*, në kuptim të përmbajtjes së nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të Ligjit Organik të Gjykatës, pasi vendimi më i fundit në kohë i kundërshtuar, ai i Gjykatës së Lartë, i datës 17.12.2024, i është komunikuar mbrojtësit të kërkuetit në adresën e tij të postës elektronike në datën 24.2.2025, ndërsa kërkesa është paraqitur në këtë Gjykatë në datën 11.6.2025, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

25. Në lidhje me legjitimitimin *ratione materiae*, kërkuesi, ndër të tjera, ka pretenduar edhe cenimin e *parimit të paanshmërisë*, për shkak se kur kërkesa për zëvendësimin e masës së sigurimit është paraqitur nga ai, gjyqtarja e hetimit paraprak pranë GJKKO-së së Shkallës së Parë nuk ka zbatuar afatet procedurale të parashikuara nga ligji. Sipas kërkuetit, e njëjta gjyqtare ka bërë një trajtim të ndryshëm të kërkesave të paraqitura nga ai në raport me kërkesat e paraqitura nga organi i akuzës, ndonëse, sipas tij, mosrespektimi i afateve procedurale në të dyja rastet nuk shoqërohet me ndonjë pasojë. Po sipas kërkuetit, njëanshmëria e gjyqtarës së hetimit paraprak është perceptuar prej tij nisur nga sjellja e saj, e cila e ka vendosur atë në pozita procedurale jo të barabarta me organin e akuzës.

26. Në jurisprudencën kushtetuese është pohuar se parimi i paanshmërisë nënkupton mungesën e paragjyqimeve nga gjyqtarët në lidhje me çështjen e shtruar përpara tyre dhe që ata të mos veprojnë në mënyrë të tillë që të ndihmojnë interesat e njëres prej palëve. Një gjykatë duhet të jetë e paanshme jo vetëm formalisht, por edhe në mënyrë të shprehur. E drejta për t’u gjykuar përpara një gjykate kompetente, të pavarur dhe të paanshme të caktuar me ligj kërkon që drejtësia jo vetëm duhet të bëhet, por ajo gjithashtu duhet të shikohet që bëhet (*shih vendimet nr. 49, datë 16.10.2023; nr. 38, datë 15.10.2007, të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Gjykata ka theksuar se respektimi i parimit të paanshmërisë duhet të verifikohet duke aplikuar testin *subjektiv*, që ka të bëjë me verifikimin e bindjes ose interesit personal të një gjyqtari në një çështje të caktuar dhe testin *objektiv*, me të cilin shqyrtohet nëse gjyqtari ka ofruar garanci procedurale të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim legjitim të anshmërisë (*shih vendimet nr. 49, datë 16.10.2023; nr. 23, datë 4.11.2008; nr. 7, datë 11.3.2008, të Gjykatës Kushtetuese*). Veçanërisht për sa i përket kriterit të dytë, nëse ky kriter zbatohet për anëtarët e trupit gjykues, ai nënkupton se përveç sjelljes personale të çdo anëtari të trupit gjykues, duhet të provohet nëse ka fakte bindëse të cilat vënë në dyshim paanshmërinë. Në këtë kuadër, edhe dukja e jashtme mund të ketë njëfarë rëndësie. Në përcaktimin nëse një çështje konkrete ka arsye logjike për të dyshuar se një gjyqtar nuk është i paanshëm, këndvështrimi i atyre që ankohen për diçka të tillë është i rëndësishëm, por jo vendimtar. Në fakt, vendimtare është nëse objektiviteti i këtyre dyshimeve është mjaftueshëm i bazuar (*shih vendimin nr. 49, datë 16.10.2023, të Gjykatës Kushtetuese*).

28. Duke iu kthyer rastit konkret, Gjykata vlerëson se ashtu sikurse ka arsyetuar edhe Gjykata e Lartë mënyra sesi disponon gjykata lidhur me çdo kërkesë të palëve gjatë procesit gjyqësor është objekt kontrolli nga gjykatat më të larta dhe nuk përbën shkak njëanshmërie. Po

sipas Gjykatës së Lartë, marrja e vendimeve nga gjyqtarët dhe menaxhimi i gjykimit prej trupit gjykues dhe kryesuesit janë shfaqje e çmuarjes dhe vlerësimit që i njihet gjyqtarit në gjykimin e çështjes, si shprehje e pavarësisë dhe paanësisë së tij. Prandaj, Gjykata konstaton se kërkuesi nuk ka arritur të provojë lidhjen e drejtpërdrejtë të bindjes së brendshme që gjyqtarja ka krijuar në vlerësimin e informacionit të organit të akuzës dhe vijimin e zbatimit ndaj tij të masës së sigurimit personal. Në këtë kuptim, Gjykata çmon se argumentet e kërkuesit për cenimin e këtij parimi, në drejtim të elementit *objektiv*, nuk janë të mjaftueshme për të arritur në përfundimin se ka pasur njëanshmëri të gjyqtarës së GJKKO-së së Shkallës së Parë në shqyrtimin e çështjes. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se ky pretendim i kërkuesit është haptazi i pabazuar.

29. Ndërsa për sa i përket pretendimit për cenimin e *paanshmërisë dhe të pavarësisë*, për shkak të parashikimeve të neneve 42 dhe 48-51 të ligjit nr. 95/2016, Gjykata vëren se këtë pretendim kërkuesi e ka ngritur më parë pranë saj në ankimet kushtetuese individuale të paraqitura në datat 29.7.2024 dhe 18.11.2024, të shqyrtuara përkatësisht me vendimet nr. 81/2024 (ankimi i datës 29.7.2024) dhe nr. 1/2025 (ankimi i datës 18.11.2025). Në shqyrtimin e këtij pretendimi të kërkuesit, Gjykata, me vendimin e saj nr. 81/2024, ka vlerësuar se përmbajtja e neneve 48-51 të ligjit nr. 95/2016 nuk cenon parimin e pavarësisë dhe paanshmërisë në gjykim dhe se ligji përmban garanci të mjaftueshme për të siguruar pavarësinë e gjyqtarëve në mënyrën sesi realizohet kontrolli (*shih paragrafët 65-77*). Ndërsa me vendimin nr. 1/2025, në shqyrtimin e të njëjtave argumente të paraqitura nga kërkuesi, Gjykata ka evidentuar se ato i janë nënshtruar tashmë vlerësimit kushtetues dhe janë bërë objekt i një vendimmarrjeje të mëparshme kushtetuese me vendimin nr. 81/2024 të saj, duke u gjendur të pabazuara, dhe për këtë arsye nuk mund të merreshin në shqyrtim. Për të njëjtat arsye, Gjykata çmon se edhe në rastin konkret këto argumente të kërkuesit, për cenimin e parimeve të paanshmërisë dhe pavarësisë, nuk mund të merren në shqyrtim.

30. Po ashtu, Gjykata konstaton se kërkuesi ka pretenduar se i është cenuar liria personale, duke iu caktuar masa e sigurimit “Arresti në shtëpi” në *mungesë të shkakut ligjor*, pasi, sipas tij, vendimi nr. 112/2023 i GJKKO-së së Shkallës së Parë, mbi bazën e të cilit ishin caktuar masat e sigurimit personal “Detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore” dhe “Ndalimi i daljes jashtë shtetit”, nuk ka qenë i ekzekutueshëm deri në datën 21.11.2023, kur ka marrë formë të prerë. Sipas kërkuesit, në datat që prokuroria pretendon se ai duhej të paraqitej në Policinë Gjyqësore, vendimi gjyqësor që ka vendosur këtë detyrim nuk ka qenë i ekzekutueshëm, pasi ndaj tij ishte bërë ankim dhe se në rastin e zëvendësimit të masave të sigurimit personal të vendosura ndaj tij, gjykatat nuk kanë hetuar kur ka lindur detyrimi i kërkuesit për zbatimin e masave të sigurimit të caktuara me vendimin nr. 112/2023 të GJKKO-së së Shkallës së Parë.

31. Në lidhje me këtë pretendim të kërkuesit, Gjykata vëren se ai nuk lidhet me procesin gjyqësor, vendimet e të cilit janë objekt i këtij ankimi kushtetues, por me procesin e dytë gjyqësor, në të cilin masa e sigurimit personal “Detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore” është zëvendësuar me “Arresti në shtëpi”, vendimet e të cilit janë shqyrtuar nga Gjykata me vendimin nr. 1/2025. Për këtë arsye, për sa kohë këto argumente të kërkuesit nuk kanë të bëjnë me procesin gjyqësor, vendimet e të cilit janë kundërshtuar nëpërmjet këtij ankimi kushtetues, por me një proces tjetër gjyqësor, i cili është bërë objekt gjykimi më parë nga Gjykata, Gjykata çmon se ky pretendim nuk mund të merret në shqyrtim.

32. Kërkuesi ka pretenduar edhe cenimin e *së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj*, pasi, sipas tij, gjyqtarja I.Gj., e cila ka disponuar me vendim në gjykatën e shkallës së parë, është dënuar nga një autoritet gjyqësor i huaj për kryerjen e një vepre penale dhe për këtë shkak ajo ka qenë në kushtet e mbarimit të statusit të magjistratit. Sipas kërkuesit, ai i është drejtuar edhe KLGJ-së, e cila e ka vlerësuar të panevojshme kryerjen e verifikimeve për këtë fakt.

33. Në rastin konkret, Gjykata evidenton se çështja që ngrihet nga kërkuesi ka të bëjë me faktin se gjyqtarja I.Gj. ka qenë në kushtet e ndalimit të ushtrimit të funksionit për shkak të ligjit, ndaj ushtrimi i tij në rastin konkret ka cenuar të drejtën për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj. Gjykata është shprehur edhe më parë për një pretendim të tillë, duke vërejtur se nuk ka ndonjë akt të organit publik të ngarkuar nga ligji që të ketë vendosur për ndalimin e ushtrimit të funksionit nga ajo gjyqtare për shkakun e pretenduar nga kërkuesi ose për ndonjë shkak tjetër ligjor. Në këtë kuptim, gjyqtarja në fjalë, ndërsa ka qenë në detyrë, në kushtet kur nuk është provuar e kundërta, ka vepruar në kushte legjitimiteti në ushtrimin e funksioneve dhe, për pasojë, pretendimi i kërkuesit është qartazi pa bazë ligjore (*shih vendimin nr. 42, datë 1.7.2025, të Gjykatës Kushtetuese*). Për rrjedhojë, me të njëjtin arsyetim, Gjykata çmon se ky pretendim i kërkuesit është haptazi i pabazuar *ratione materiae*.

34. Për sa u përket pretendimeve të tjera të parashtruara në ankimin kushtetues individual, si atyre në aspektin *procedural*, ashtu edhe atyre në aspektin *substancial*, Gjykata vëren se kërkuesi në thelb ka pretenduar se gjykatat në kufizimin e lirisë së tij personale kanë dhënë të njëjtat argumente që kanë dhënë kur kanë caktuar masat e para të sigurimit personal “Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore” dhe “Ndalimi i daljes jashtë shtetit”. Po sipas kërkuesit, gjykatat nuk kanë dhënë argumente të mjaftueshme për nevojën e kohëzgjatjes së masës së sigurimit personal “Arresti në shtëpi”, për vazhdimin e kufizimit të lirisë personale dhe të drejtave të tjera të tij, duke mos arsyetuar as domosdoshmërinë e vazhdimin të masës së sigurimit personal “Arresti në shtëpi”.

35. Lidhur me kufizimin e lirisë personale, si pasojë e zbatimit të masës së sigurimit “Arresti në shtëpi”, Gjykata, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, ka theksuar se kjo masë konsiderohet, për nga shkalla dhe intensiteti i saj, si privim i lirisë në kuptim të nenit 5 të KEDNJ-së, dhe pavarësisht nga vendi në të cilin zbatohet masa e sigurimit, pra në paraburgim apo me arrest në shtëpi, ndaj kërkuesit zbatohen të njëjtat kritere për të gjithë periudhën e kufizimit të lirisë (*shih vendimet nr. 40, datë 17.6.2025; nr. 17, datë 13.3.2024, të Gjykatës Kushtetuese*). Sipas Gjykatës, liria personale ka dy aspekte: atë substancial, që garantohet nga neni 27 i Kushtetutës, dhe atë procedural, që garantohet nga neni 28 i lidhur me nenin 42 të Kushtetutës. Në rastet e kontrollit të vendimeve që caktojnë masat e sigurimit personal, ajo i trajton pretendimet e parashtruara në ankimin kushtetues në drejtim të të drejtave substanciale, ndërsa pretendimet që kanë të bëjnë me të drejtën për proces të rregullt ligjor trajtohen si aspekte procedurale të së drejtës substanciale të pretenduar të cenuar. Në këtë kuptim, Gjykata edhe në jurisprudencën e saj është shprehur se ajo ndalet në aspekte të veçanta të së drejtës për proces të rregullt ligjor, për sa ato mund të ndikojnë drejtpërdrejt në të drejtën substanciale në vetvete (*shih vendimet nr. 86, datë 30.12.2024; nr. 29, datë 16.4.2024; nr. 18, datë 19.3.2024, të Gjykatës Kushtetuese*).

36. Në këndvështrim të sa më sipër, Gjykata vëren se procesi gjyqësor në të cilin ndaj kërkuesit është caktuar masa e sigurimit personal “Arresti në shtëpi” (procesi i dytë), është bërë objekt i kontrollit kushtetues prej saj, dhe me vendimin nr. 1/2025 është vendosur rrëzimi i kërkesës, duke mos u konstatuar kështu probleme kushtetutshmërie në vendosjen e saj. Për rrjedhojë, në kushtet kur ajo masë siguri (Arresti në shtëpi) është caktuar ndaj kërkuesit për shkak se ai nuk ka respektuar një prej urdhërimeve të vendosura më parë ndaj tij, konkretisht detyrimin për t'u paraqitur në Policinë Gjyqësore, Gjykata në vijim do ta shqyrtojë çështjen në këndvështrim të lirisë personale në aspektin substancial, sipas nenit 27 të Kushtetutës, duke mos vënë në dyshim ndërhyrjen me ligj dhe interesin publik, vetëm në drejtim të proporcionalitetit dhe në aspektin procedural, sipas nenit 28 të Kushtetutës, në drejtim të kohëzgjatjes së masës së sigurimit, duke iu referuar për këtë qëllim analizës së vendimeve të gjykatave, objekt i këtij gjykimi kushtetues.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e lirisë personale

37. Kërkuesi ka pretenduar se gjykatat në kufizimin e lirisë së tij personale kanë dhënë të njëjtat argumente që kanë dhënë kur kanë caktuar masat e para të sigurimit personal “Detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore” dhe “Ndalimi i daljes jashtë shtetit”. Po ashtu, kërkuesi ka argumentuar se arsyetimi i gjykatave vjen në kundërshtim me qëndrimin e organit të akuzës, sipas të cilit nuk ekziston rreziku i ikjes së tij. Sipas kërkuesit, gjykatat nuk kanë dhënë argumente të mjaftueshme për nevojën e kohëzgjatjes së masës së sigurimit personal “Arresti në shtëpi” dhe vazhdimin, zgjatjen e kufizimit të lirisë personale dhe të të drejtave të tjera kushtetuese, duke mos arsyetuar as domosdoshmërinë e vijimit të asaj mase sigurimi.

38. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme, ka prapësuar duke argumentuar se në rastin konkret, nga gjykatat e të gjitha shkallëve, është respektuar kriteri kushtetues i dyshimit të arsyeshëm, si kusht *sine qua non* për justifikimin e kufizimit të lirisë personale të kërkuesit. Po ashtu, subjekti i interesuar ka argumentuar se nga gjykatat është arsyetuar mjaftueshëm në lidhje me plotësimin e kushteve të veçanta për caktimin e masës së sigurimit, rrezikut të ikjes së personit dhe rrezikut të ndërhyrjes së tij në marrjen e provave.

39. Gjykata ripohon se çdo masë që kufizon liritë dhe të drejtat e individit duhet të jetë në përputhje me ligjin, të ndjekë një qëllim legjitim dhe të respektojë një ekuilibër të drejtë midis interesit publik dhe të drejtave e lirive të tij. Një ndërhyrje do të konsiderohet “e nevojshme në një shoqëri demokratike” për një qëllim të ligjshëm nëse i përgjigjet një “nevoje sociale urgjente” dhe, në veçanti, nëse është proporcionale me qëllimin legjitim të ndjekur dhe nëse arsyet e gjykatave për ta justifikuar atë janë “relevante dhe të mjaftueshme”. Testi i proporcionalitetit të ndërhyrjes kërkon që masa të jetë e përshtatshme për të arritur funksionin mbrojtës. Me fjalë të tjera, një kufizim është i justifikueshëm vetëm për atë sa ai ndihmon në arritjen e qëllimit legjitim të synuar. Vlerësimi i proporcionalitetit të ndërhyrjes bazohet në tri shtylla kryesore: justifikimi i kufizimit nën dritën e funksionit të tij mbrojtës; cilësia e vlerësimit të brendshëm; ashpërsia e kufizimit (*shih vendimet nr. 1, datë 17.1.2025; nr. 81, datë 21.11.2024, të Gjykatës Kushtetuese*).

40. Gjithashtu, Gjykata ka vlerësuar se çdo kufizim i lirisë duhet të jetë në përputhje me qëllimin e mbrojtjes së individëve nga arbitrariteti dhe se ai do të konsiderohet arbitrar, midis të tjerash, në rastet kur nuk është në përpjesëtim me shkakun ligjor për të cilin është vendosur. Në këtë drejtim, Gjykata ka identifikuar disa shkaqe që konsiderohen të pranueshme për të justifikuar ndërhyrjen në lirinë personale, siç janë: a) rreziku që i dyshuari/akuzuari në qoftë se do të lihej i lirë do të largohej dhe nuk do të paraqitej përpara gjykatës; b) rreziku që i dyshuari/akuzuari, në qoftë se do të lihej i lirë do të ndërmernte veprime për të penguar dhënien e drejtësisë; c) rreziku që i dyshuari/akuzuari nëse do të lihej i lirë do të kryente vepra penale të tjera (*shih vendimet nr. 1, datë 17.1.2025; nr. 19, datë 21.3.2024, të Gjykatës Kushtetuese*).

41. Ndërsa në lidhje me kohëzgjatjen e masës së sigurimit, Gjykata ka pohuar se çështja nëse një periudhë kohore e kaluar në paraburgim është e arsyeshme nuk mund të vlerësohet në mënyrë abstrakte, por në bazë të fakteve të secilit rast dhe veçorive të tij specifike. Prandaj, vazhdimi i paraburgimit mund të justifikohet në një rast të caktuar vetëm nëse ka tregues specifikë të një kërkese të vërtetë të interesit publik, e cila, pavarësisht nga prezumimi i pafajësisë, tejkalon rregullin e respektimit të lirisë individuale të përcaktuar në nenin 5 të KEDNJ-së (*shih vendimin nr. 86, datë 30.12.2014, të Gjykatës Kushtetuese*).

42. Në jurisprudencën e GJEDNJ-së, edhe pse vijimi i një dyshimi të arsyeshëm është kusht *sine qua non* për vlefshmërinë e arrestit në burg, ai nuk mjafton më pasi kalon një kohë e caktuar. Në këtë rast, Gjykata duhet të verifikojë nëse shkaqe të tjera të dhëna nga autoritetet gjyqësore vazhdojnë të justifikojnë heqjen e lirisë. Nëse këto shkaqe janë “relevante” dhe “të mjaftueshme”, Gjykata gjithashtu duhet të sigurohet nëse autoritetet kompetente kombëtare kanë treguar “kujdesin e veçantë” në zhvillimin e procesit (*shih Gëllçi kundër Shqipërisë, datë 25.2.2025, § 19; Buzadji kundër Republikës së Moldavisë [DHM], datë 5.7.2016, §§ 84-91, 102*). Në jurisprudencën e GJEDNJ-së shkaqet janë konsideruar “relevante” dhe “të

mjaftueshme” (përveç ekzistencës së dyshimit të arsyeshëm) kur ekziston: i. rreziku që i akuzuari të mos paraqitet në gjyq; ii. rreziku që i akuzuari, nëse lirohet, të ndërmarrë veprime për të dëmtuar administrimin e drejtësisë; iii. rreziku që të kryejë vepra të mëtejshme penal; (iv) rreziku që të shkaktojë çrregullime publike (*shih Buzadji kundër Republikës së Moldavisë [DHM], datë 5.7.2016, § 88; Piruzyan kundër Armenisë, 2012, § 94*). Në këtë kuptim, GJEDNJ-ja ka vlerësuar se vendimi i saj nëse ka pasur ose jo cenim të nenit 5, pika 3, të KEDNJ-së do të merret bazuar në arsyetimin e vendimeve të autoriteteve kombëtare (*shih Buzadji kundër Republikës së Moldavisë [DhM], datë 5.7.2016, §§ 89-91; McKay kundër Mbretërisë së Bashkuar [DhM], datë 3.10.2006, §§ 41-43*).

43. Po ashtu, GJEDNJ-ja, në lidhje me nenin 5, pika 1, të KEDNJ-së ka pohuar se në një shoqëri demokratike autoritetet vendase duhet të gjejnë një ekuilibër të drejtë midis rëndësisë për sigurimin e zbatimit të një urdhri të ligjshëm të gjykatës dhe rëndësisë së lirisë personale. Në rrethana të tilla, çështje të tilla si qëllimi i urdhrit, mundësia e pajtueshmërisë me urdhrin dhe kohëzgjatja e ndalimit, janë çështje që duhen marrë në konsideratë. Në skemën e përgjithshme të gjërave, çështja e proporcionalitetit merr një rëndësi të veçantë (*shih Gatt kundër Maltës, datë 27.7.2010, § 40*). Sipas GJEDNJ-së, neni 5, pika 1, i KEDNJ-së përmban një listë shteruese të shkaqeve që lejojnë heqjen e lirisë. Megjithatë, zbatimi i një shkakut nuk përjashton domosdoshmërisht shkakun tjetër; në varësi të rrethanave, heqja e lirisë së një individi mund të justifikohet bazuar në më shumë se një nënpikë (*shih Eriksen kundër Norvegjisë, 27.5.1997, § 76; Enhorn kundër Suedisë, datë 25.1.2005, § 34*).

44. Duke mbajtur parasysh strukturën e pikës 2 të nenit 27 të Kushtetutës, Gjykata vëren se kërkuesit i është hequr liria jo vetëm bazuar në shkronjën “c” të saj, pra për shkak të dyshimeve të arsyeshme për kryerjen prej tij të veprës penale, por edhe bazuar në shkronjën “b”, pra për moszbatimin e urdhrit të ligjshëm të gjykatës për t’u paraqitur në Policinë Gjyqësore.

45. Referuar rrethanave të rastit konkret, Gjykata konstaton se në datën 20.10.2023 ndaj kërkuesit, mbi kërkesën e Prokurorisë së Posaçme, nga gjykatat e zakonshme janë vendosur masat e sigurimit personal “*Detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore*” dhe “*Ndalimi i daljes jashtë shtetit*”, pasi në vlerësimin e nevojave të sigurimit gjykatat kanë pranuar se ekzistonin shkaqe që vinin në rrezik marrjen ose vërtetësinë e provës dhe, po ashtu, ekzistonte edhe rreziku i ikjes së kërkuesit (procesi i parë). Në lidhje me këto vendime gjyqësore, Gjykata, me vendimin nr. 81/2024, ka vendosur shfuqizimin e tyre, si të papajtueshme me Kushtetutën, vetëm për pjesën që kanë caktuar masën e sigurimit personal “*Ndalimi i daljes jashtë shtetit*”, me arsyetimin se në caktimin ndaj kërkuesit të këtyre dy masave vendimeve të gjykatave u mungonte arsyetimi, për rrjedhojë nuk rezultonte që të kishin vlerësuar nevojën për caktimin e tyre. Për shkak se kërkuesi nuk ka respektuar njërën prej masave të sigurimit të caktuar nga gjykata, konkretisht “*Detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore*”, mbi kërkesën e Prokurorisë së Posaçme gjykatat e zakonshme, në datën 30.12.2023, kanë zëvendësuar masat e sigurimit të vendosura ndaj tij me masën “*Arresti në shtëpi*” (procesi i dytë). Edhe procesi gjyqësor në lidhje me masën “*Arresti në shtëpi*” është bërë objekt i kontrollit kushtetues nga Gjykata, e cila, me vendimin nr. 1/2025, ka vendosur rrëzimin e kërkesës.

46. Ndërkohë, rasti objekt i këtij gjykimi kushtetues lidhet me kërkesën që Prokuroria e Posaçme ka paraqitur pranë GJKKO-së së Shkallës së Parë në kuadër të hetimit dymujor për kërkuesin, duke kërkuar vijimin e zbatimit të masës së sigurimit personal “*Arresti në shtëpi*”. Kjo kërkesë është pranuar nga GJKKO-ja e Shkallës së Parë me vendimin e datës 30.7.2024. Vendimi është lënë në fuqi nga GJKKO-ja e Apelit, ndërsa Kolegji Penal i Gjykatë së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit.

47. Për sa më lart, Gjykata në vijim do të verifikojë nëse vazhdimi, zgjatja e qëndrimit të kërkuesit nën masën e sigurimit “*Arresti në shtëpi*”, e cila ka passjellë dhe kufizimin e lirisë personale të tij, është bërë në mënyrë proporcionale me nevojat e hetimit, pra nëse ka arritur një ekuilibër të drejtë midis rëndësisë për sigurimin e zbatimit të një urdhri të ligjshëm të

gjykatës dhe së drejtës për liri të kërkuesit, dhe nëse periudha e kufizimit të lirisë ka qenë në përputhje me qëllimin e vendosjes së urdhërimit të caktuar më parë nga gjykatat. Në këtë drejtim, Gjykata do të analizojë, gjithashtu, nëse vendimet e gjykatave që kanë lejuar vijimin, zgjatjen e masës së sigurimit “Arresti në shtëpi”, kanë arsyetuar mjaftueshëm dhe jo në mënyrë të përgjithshme për vijimin, zgjatjen e masës së sigurimit të kërkuesit dhe nëse është justifikuar nga gjykatat nevoja e kohëzgjatjes me atë masë.

48. Në rastin konkret, në pranimin e kërkesës së Prokurorisë së Posaçme për vijimin e zbatimit të masës së sigurimit personal “Arresti në shtëpi”, të caktuar ndaj kërkuesit me vendimin nr. 520/2023 të GJKKO-së së Shkallës së Parë, kjo e fundit, me vendimin nr. 400/2024, ka arsyetuar se pas caktimit të masave të sigurimit personal të vendosura ndaj kërkuesit, nga ana e organit të akuzës janë kryer veprime hetimore, të cilat pasqyrojnë se është treguar diligenca e duhur në ushtrimin e ndjekjes penale. Po ashtu, GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka arsyetuar se referuar pretendimeve të paraqitura nga organi i akuzës dhe veprimeve hetimore të kryera, ky i fundit provoi se ka treguar kujdes dhe ka bërë përpjekjet e duhura për të përmbushur në substancë qëllimin e veprimeve hetimore, në rrethanat që ka nisur procedimi penal. Po ashtu, sipas GJKKO-së së Shkallës së Parë, që nga data e caktimit të masave fillestare të sigurimit me vendimin nr. 112/2023 dhe deri në datën e paraqitjes së kërkesës së informacionit dymujor nga ana e Prokurorisë së Posaçme, nuk rezulton të kenë ndryshuar kushtet për masat e sigurimit të vendosura dhe nuk rezulton mospajtim i masave të aplikuara me ato kushte e kritere që kanë shërbyer për vendosjen e tyre, si dhe nuk rezulton të kenë ndryshuar rrethanat e faktit e të ligjit. Në vlerësimin e GJKKO-së së Shkallës së Parë, nga ana e organit të akuzës janë kryer një sërë veprimesh hetimore, që nga pyetja e disa personave, të cilët kanë dhënë informacione të dobishme për hetimin dhe janë administruar një tërësi provash shkresore, siç janë: verifikimet e kryera pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës dhe Drejtorisë Rajonale të Tatimeve; administrimi i të dhënave nga Ministria e Drejtësisë që lidhen me ushtrimin e aktivitetit të noteres L.P. dhe sekuestrimi pranë kësaj të fundit të një sërë dokumenteve. Sipas GJKKO-së së Shkallës së Parë, nga analiza në tërësi e veprimeve hetimore vijon të ekzistojë mbi të hetuarit “*dyshimi arsyeshëm*”, i bazuar në prova (*fumus cemmisi delicti*), kushti bazë për caktimin e masave të sigurimit (neni 228, pika 1, të KPP-së), se ata janë autorë të veprave penale për të cilat akuzohen. Po ashtu, GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka arsyetuar se nga hetimi i deritanishëm rezulton se nuk ka ndryshim të kritereve dhe të kushteve për të cilat është caktuar masa e sigurimit, si dhe nuk rezulton që të jetë lehtësuar pozita e të hetuarve (*shih faqet 37–39 të vendimit të GJKKO-së së Shkallës së Parë*).

49. Më tej, GJKKO-ja e Shkallës së Parë në vendimin e saj ka arsyetuar edhe lidhur me pretendimet e kërkuesit për kryerjen nga ana e organit të akuzës të veprimeve hetimore të përsëritura ose që nuk lidhen me veprat penale që u atribuohen të hetuarve, duke arsyetuar se ato janë të pabazuara. Sipas GJKKO-së së Shkallës së Parë, në rastin konkret nga organi i akuzës u argumentua për arsyet e kryerjes së veprimeve hetimore respektive dhe lidhjen e tyre në substancë me të hetuarit dhe me veprat penale që u atribuohen. Po ashtu, GJKKO-ja e Shkallës së Parë e ka vlerësuar si të pabazuar edhe pretendimin tjetër të kërkuesit se janë duke u hetuar marrëdhënie civile, ku, sipas saj, është çmuar e domosdoshme edhe shtrirja e hetimit në këtë aspekt, duke pasur parasysh se marrëdhëniet juridiko-civile nuk janë asnjëherë të zhveshura nga elementet penale. GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka arsyetuar edhe në lidhje me pretendimin e kërkuesit për pavlefshmërinë e akteve të ekspertimit, duke vlerësuar se nuk mund të disponojë në lidhje me këtë kërkim për sa kohë çështja është në fazën e hetimit paraprak dhe ajo mund të bëhet në shqyrtimin në themel të çështjes. GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka arsyetuar edhe në lidhje me pretendimin e kërkuesit se caktimi i masës së sigurimit të vendosur ndaj tij ka pasur në bazë vetëm moszbatimin nga kërkuesi të masës së sigurimit “Detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”, duke vlerësuar se fakti se ai nuk ka zbatuar urdhërimet e gjykatës në vendimet e dhëna prej saj, është vlerësuar në raport me të gjitha të

dhënat e tjera dhe ka shërbyer si një indikator lidhur me kriterin e tretë, atë të veçorive individuale të personit nën hetim. Në lidhje me pretendimin e kërkuarit për ekzekutimin e masës së sigurimit “Detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”, GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka arsyetuar se këto argumente nuk janë objekt i këtij gjykimi dhe nuk mund të merren parasysh, dhe se janë trajtuar gjerësisht në vendimet e caktimit/verifikimit të masave të sigurimit. Po sipas GJKKO-së së Shkallës së Parë, vijojnë të ekzistojnë kushtet dhe kriteret dhe justifikohet vazhdimi i zbatimit të masave të sigurimit të caktuara ndaj kërkuarit, ndaj pretendimi i tij në këtë drejtim nuk është i bazuar (*shih faqet 39-42 të vendimit të GJKKO-së së Shkallës së Parë*).

50. Në përfundim, GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka arsyetuar se nevojat e sigurimit në ngarkim të kërkuarit, lidhur me rrezikun e dëmtimit të provave për sqarimin e fakteve penale, janë të tilla që justifikojnë masën e sigurimit “Arresti në shtëpi”, pasi çështja ndodhet ende në fazën e hetimeve dhe nga ana e organit të akuzës duhet të kryhen ende veprime hetimore dhe procedurale në funksion të këtij hetimi. Sipas GJKKO-së së Shkallës së Parë, për shkak të marrëdhënieve të krijuara si rezultat i ushtrimit të funksioneve që ka pasur kërkuari dhe influencave që mund të ketë te persona të tjerë, vijon të ekzistojë mundësia që ai të ndërhyjë dhe të ndikojë në prishjen ose asgjësimin e provave, si dhe në krijimin e rrethanave që vështirësojnë mbledhjen e provave. Po ashtu, GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka arsyetuar edhe në lidhje me rrezikun e largimit të të hetuarve, duke vlerësuar se ai vazhdon të jetë ende prezent (*shih faqet 44-45 të vendimit të GJKKO-së së Shkallës së Parë*).

51. Mbi ankimin e kërkuarit, GJKKO-ja e Apelit ka vendosur miratimin e vendimit nr. 400/2024 të GJKKO-së së Shkallës së Parë. Sipas GJKKO-së së Apelit, vendimmarrja e GJKKO-së së Shkallës së Parë është e drejtë dhe nevojat e sigurimit të të hetuarve ose mbajtja nën kontroll paraprak e rreziqeve të mundshme të procedimit nga lënia në liri e tyre ose pa masë sigurimi mbeten të pandryshuara ose të qëndrueshme, njësoj si në kohën e caktimit të masave të sigurimit, pasi nuk kanë ndryshuar rrethanat për të cilat janë vendosur ato. Sipas GJKKO-së së Apelit, referuar nenit 228, pika 3, shkronjat “a” dhe “b”, të KPP-së, në rastin konkret ekziston frika dhe rreziku që lënia në liri e kërkuarit mund të cenojë procesin e mbledhjes dhe vërtetësisë së provave, si dhe frika e largimit të tij për t’iu shmangur procedimit, të cilat konstatohet se janë konkrete dhe aktualisht prezente si në gjenezën e caktimit të masës së sigurimit personal ndaj tij. Po sipas GJKKO-së së Apelit, nevojat e sigurimit në rastin e kërkuarit paraqiten të pandryshuara ose të qëndrueshme, pasi nuk kanë ndryshuar rrethanat për të cilat në gjenezë është konkluduar se ai duhet të shtrëngohej me një masë sigurimi, si dhe aktualisht ky procedim ndodhet në fazën e hetimeve paraprake, nga deduktohet se rreziku i parashikuar nga neni 228, pika 3, shkronja “a”, i KPP-së është i lartë dhe po ashtu i njëjtë me momentin e gjenezës së masës së sigurimit të caktuar ndaj tij. Po ashtu, GJKKO-ja e Apelit ka arsyetuar se i qëndrueshëm dhe aktual është edhe rreziku i ikjes së kërkuarit për t’iu shmangur drejtësisë, nisur nga dëshira natyrale për të ruajtur lirinë, në kushtet kur vepra penale objekt dyshimi parashikon dënimin me burgim. Për këto arsye, GJKKO-ja e Apelit ka vlerësuar se kërkimi i kërkuarit për revokimin e masës së sigurimit është i pabazuar në përcaktimet e nenit 260, pika 1, të KPP-së. Në vlerësimin e GJKKO-së së Apelit, në përputhje me përcaktimet dhe frymën e nenit 246, pika 6, të KPP-së, organi i akuzës ka treguar diligjencën ose kujdesin e duhur në ushtrimin e ndjekjes penale dhe zhvillimin e hetimeve të këtij procedimi, si në numrin e veprimeve hetimore të kryera, ashtu edhe në rëndësinë e tyre (*shih faqet 4 e në vijim të vendimit të GJKKO-së së Apelit*).

52. Mbi rekursin e kërkuarit, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit, për shkak se nuk përmbante asnjë nga shkaqet e parashikuara nga neni 432 i KPP-së. Sipas Kolegjit Penal, gjykatat më të ulëta kanë argumentuar vendimmarrjet e tyre dhe u kanë dhënë përgjigje në thelb shkaqeve të parashtruara nga kërkuari, si dhe arsyetimet e tyre janë plotësuese të njëra-tjetrës. Po sipas Kolegjit Penal, të dyja gjykatat kanë argumentuar

mjaftueshëm edhe ligjshmërinë e vazhdimit të zbatimit të masave të sigurimit personal ndaj të hetuarve, si dhe kanë analizuar kushtet dhe kriteret e parashikuara në ligj për caktimin e masave të sigurimit personal. Në vlerësimin e Kolegjit Penal, pretendimet e kërkuarit për shkeljen e dispozitave kushtetuese dhe procedurale gjatë vendimmarrjeve për caktimin e masave të sigurimit personal që në gjenezë ndaj tij dhe ato për zëvendësimin *in peius* kanë marrë përgjigje në vendimmarrjet e mëparshme, duke përbërë gjë të gjykuar, prandaj pretendimi i tij në këtë drejtim nuk është i bazuar. Në vlerësimin e Kolegjit Penal edhe pretendimet e ngritura në rekurs për cenimin e parimeve të paanshmërisë dhe pavarësisë janë të pabazuara, duke arsyetuar se marrja e vendimeve nga gjyqtarët dhe menaxhimi i gjyqimit prej trupit gjykues dhe kryesuesit janë shfaqje e çmuarjes dhe vlerësimit që i njihet gjyqtarit në gjykimin e çështjes, si shprehje e pavarësisë dhe paanësisë së tij. Për sa u përket pretendimeve për dispozitat e ligjit nr. 95/2016, Kolegji Penal ka vlerësuar se pretendimet e kërkuarit në këtë drejtim janë të pabazuara dhe nuk cenojnë vendimmarrjen objekt rekursi, për sa kohë janë ato parashikime ligjore që ofrojnë garanci në drejtim të pavarësisë dhe paanësisë në proces. Po ashtu, Kolegji Penal ka arsyetuar se gjykatat kanë arsyetuar mjaftueshëm për ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm të bazuar në prova (të përforcuar me vijimin e hetimeve) se të hetuarit mund të kenë kryer veprat penale për të cilat akuzohen (*shih paragrafët 16 e në vijim të vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë*).

53. Për sa më lart, referuar arsyetimit të vendimeve të gjykatave të zakonshme, Gjykata konstaton se këto të fundit në shqyrtimin e kushteve dhe të kriterëve për vijimin, zgjatjen e masës së sigurimit “Arresti në shtëpi” (të caktuar në procesin e dytë), në thelb, kanë arsyetuar se nevojat e sigurimit paraqiten të pandryshuara me ato për të cilat në gjenezë është konkluduar se kërkuari duhej të vendosej nën një masë sigurimi. Në këtë kuptim, Gjykata evidenton se gjykatat që kanë lejuar vijimin, zgjatjen e masës së sigurimit personal “Arresti në shtëpi” u janë referuar të njëjtave nevoja sigurimi si në momentin fillestar kur janë caktuar masat e sigurimit ndaj kërkuarit “Detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore” dhe “Ndalimi i daljes jashtë shtetit” (procesi i parë). Gjykata konstaton se për këtë të fundit në vendimin e saj nr. 81/2024 ka konsideruar që për sa kohë u konstatua mungesë në vlerësimin e elementit të nevojës për kufizimin e të drejtave dhe të lirive të kërkuarit, në raport me mbarëvajtjen e procedimit penal, kjo përbën shkak të mjaftueshëm për të konstatuar cenimin e parimit të proporcionalitetit në caktimin e masës “Ndalimi i daljes jashtë shtetit”. Po kështu, Gjykata, mbi bazën e të njëjtave argumente, me vendimin nr. 81/2024 të saj, konstatoi se edhe vetëm masa e sigurimit personal “Detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore” duket se i plotësonte nevojat e sigurimit.

54. Në këtë kuptim, Gjykata vëren se në vendimet e gjykatave të zakonshme objekt kontrolli, ndonëse kishin kaluar 7 muaj nga caktimi i masës së sigurimit “Arresti në shtëpi”, në lidhje me rrezikun e ikjes së kërkuarit nuk ka ndonjë arsyetim, ndërsa për rrezikun e marrjes dhe të vërtetësisë së provave organi i prokurorisë, në vijim, por edhe gjykatat e zakonshme, në momentin fillestar të caktimit të masave të sigurimit, kanë vlerësuar se përmbushej nga masa e sigurimit “Detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”. Megjithatë, për të njëjtën nevojë sigurimi dhe pa evidentuar ndonjë rrethanë të re për ndonjë sjellje konkrete të kërkuarit në aspekt të kësaj nevoje sigurimi, në rastin në shqyrtim gjykatat e zakonshme kanë konsideruar se ajo përmbushej nga një masë sigurimi më e rëndë, ajo e “Arrestit në shtëpi”.

55. Në këto kushte, Gjykata vëren se nevoja që diktoi vendosjen e masës së sigurimit “Arresti në shtëpi” lidhej me mospërmbushjen nga kërkuari të masës së sigurimit personal “Detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”, e cila ishte caktuar ndaj tij në procesin e parë. Në këtë kuptim, Gjykata konstaton se shkaku për të cilin u vendos masa e sigurimit me natyrë rënduese “Arresti në shtëpi” është i ndryshëm nga nevojat e sigurimit që kishin përligjur fillimisht caktimin e masave të sigurimit “Detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore” dhe “Ndalimi i daljes jashtë shtetit”, përkatësisht rreziku i mbledhjes dhe i vërtetësisë së

provave, si dhe rreziku i largimit të kërkuesit për t'iu shmangur procedimit. Në këtë pikë, Gjykata vëren se, për sa i takon nevojës së sigurimit që lidhet me shmangien e rrezikut të mbledhjes dhe të vërtetësisë së provave, organi i prokurorisë dhe gjykatat e zakonshme në vijim kanë konsideruar se ajo përmbushej përmes masës së sigurimit “Detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”. Për rrjedhojë, Gjykata konstaton se as organi i prokurorisë, as gjykatat e zakonshme nuk kanë parashtruar ndonjë fakt ose rrethanë specifike, të ndodhur gjatë vijimit të hetimeve, e cila të justifikonte zgjatjen e masës së sigurimit “Arresti në shtëpi” për shkak të kësaj nevojë. Po ashtu, për sa i takon nevojës së sigurimit që lidhet me rrezikun e largimit të kërkuesit për t’iu shmangur procedimit, organi i prokurorisë dhe gjykatat e zakonshme në vijim kanë konsideruar se ajo përmbushej përmes masës së sigurimit “Ndalimi i daljes jashtë shtetit”, masë e cila u vlerësua joproporcionale nga Gjykata. Edhe në këtë drejtim, Gjykata konstaton se nuk është parashtruar ndonjë fakt ose rrethanë specifike, e ndodhur gjatë vijimit të hetimeve, e cila të justifikonte zgjatjen e masës “Arresti në shtëpi” për shkak të kësaj nevojë. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se, pas kalimit të 7 muajve nga zbatimi i masës së sigurimit “Arresti në shtëpi”, të vendosur për shkak të mospërmbushjes nga kërkuesi të masës së sigurimit “Detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”, vijimi i zbatimit të saj nuk është argumentuar mbi ndonjërin nga nevojat e sigurimit që përlligjin mbajtjen në fuqi të kësaj mase. Në këto kushte, kjo masë është shndërruar praktikisht në një formë sanksioni penal, përtej natyrës dhe funksionit të masave të sigurimit personal.

56. Për këto arsye, Gjykata vëren se kufizimi i lirisë personale të kërkuesit me masën e sigurimit “Arresti në shtëpi” nuk mund të konsiderohet se arrin një ekuilibër të drejtë midis rëndësisë për sigurimin e zbatimit të një urdhri të ligjshëm të gjykatës dhe së drejtës për liri të tij. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se periudha e qëndrimit të kërkuesit nën atë masë siguri nuk ka qenë në përputhje me qëllimin e vendosjes së urdhërimit të caktuar më parë nga gjykatat, i cili nuk është zbatuar prej tij. Ndërsa lidhur me qëllimin e vijimit të asaj mase siguri në atë fazë, Gjykata konstaton se ajo nuk lidhej më me sigurimin e mbarëvajtjes së procedimit penal, arsye për të cilat vendosen masat e sigurimit personal (*shih vendimin nr. 81, datë 21.11.2024, të Gjykatës Kushtetuese*), por thjesht me faktin se kërkuesi nuk kishte respektuar një urdhërim të vendosur më parë ndaj tij nga gjykatat.

57. Për sa më lart, Gjykata konstaton se arsyetimi i vendimeve gjyqësore objekt i këtij gjykimi kushtetues nuk është i mjaftueshëm në aspektin kushtetues në vlerësimin e kësaj nevojë siguri, duke mbajtur parasysh edhe faktin se justifikimi për caktimin fillimisht të masës së sigurimit “Arresti në shtëpi” konsistonte në mosrespektimin, moszbatimin nga kërkuesi të masës së sigurimit “Detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”. Në vlerësimin e Gjykatës, vetëm një rrethanë e tillë nuk mund të justifikojë vijimin, zgjatjen e zbatimit ndaj kërkuesit të masës “Arresti në shtëpi”, pra nuk mund të përbëjë arsye të mjaftueshme për zgjatjen në kohë të gjatë të kufizimit të lirisë, pa arsyetuar për ndonjë arsye të re që justifikon vijimin, zgjatjen e masës konkrete (“Arresti në shtëpi”).

58. Për këto arsye, Gjykata vëren gjithashtu se gjykatat në lejin e vijimit, zgjatjes së masës së sigurimit “Arresti në shtëpi”, të caktuar ndaj kërkuesit, kanë arsyetuar në mënyrë të përgjithshme lidhur me kushtet dhe kriteret për të cilat është vendosur ajo, si dhe pse ato vijnë të jenë ende të nevojshme, duke mos justifikuar kështu konkretisht vazhdimin, zgjatjen e kufizimit të lirisë personale të tij. Në këtë rast, gjykatat janë bazuar mbi të njëjtat shkaqe që kanë diktuar nevojën e vendosjes së masës së sigurimit të lidhur me rrezikun e ikjes së tij ose me rrezikun e dëmtimit të provave nga kërkuesi. Në këtë kuptim, Gjykata evidenton se individualizimi i masës së sigurimit “Arresti në shtëpi” në rastin e kërkuesit nuk i përgjigjej nevojës për siguri me atë masë dhe gjykatat nuk kanë justifikuar kohëzgjatjen e saj, duke passjellë kështu edhe kufizimin e lirisë personale të kërkuesit në mënyrë joproporcionale me nevojat e hetimit. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se vendimet objekt i këtij gjykimi kushtetues,

që kanë disponuar për vijimin, zgjatjen e masës së sigurimit “Arresti në shtëpi”, janë në kundërshtim me Kushtetutën.

59. Nisur nga kjo, Gjykata arrin në përfundimin se shkaqet e dhëna nga gjykatat e posaçme dhe nga Gjykata e Lartë nuk kanë qenë të mjaftueshme në drejtim të qëllimit dhe nevojës, që të justifikonin vazhdimin, zgjatjen e masës së sigurimit personal ndaj kërkuesit “Arresti në shtëpi”, ndaj pretendimi i tij për cenimin e lirisë personale, sipas arsytimit të mësipërm, është i bazuar. Gjithsesi, duke qenë se masa e sigurimit “Arresti në shtëpi” nuk është më në fuqi, pasi GJKKO-ja e Apelit në datën 3.1.2025 ka vendosur zëvendësimin e saj me masën e sigurimit “Detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”, Gjykata çmon të mos i shfuqizojë vendimet objekt të këtij shqyrtimi kushtetues.

C. Për shpenzimet e përfaqësimit

60. Në datën 15.12.2025, përpara shqyrtimit të çështjes në seancë plenare, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me kërkesë, me objekt mbulimin e shpenzimeve në lidhje me çështjen objekt i këtij gjykimi kushtetues. Sipas kërkuesit, mbrojtja juridike ka qenë e domosdoshme, për shkak të kompleksitetit të çështjes, e cila ka pasur të bëjë jo vetëm me lirinë e tij personale, por edhe me të drejtat politike, të organizimit dhe të shprehjes, të ushtrimit të mandatit të deputetit, të procesit të rregullt ligjor, të cilat kanë pasur efekte edhe ndaj zgjedhësve të përfaqësuar prej tij. Për këtë qëllim, është paraqitur akti “Marrëveshje/kontratë shërbimi”, i nënshkruar prej kërkuesit dhe avokates e cila e përfaqëson në këtë gjykim, si dhe fatura e datës 20.11.2025, e lëshuar nga avokatja Klodiana Gjyzari, në vlerën 200,000 lekë (pa TVSH), e përshkruar si pagesë për ofrimin e shërbimit të përgatitjes së ankimit kushtetues individual.

61. Gjykata vëren se në nenin 28 të Ligjit Organik të Gjykatës janë parashikuar rregullat për sa u takon shpenzimeve gjyqësore, sipas të cilave, shpenzimet e procesit gjyqësor përpara saj u nënshtrohen rregullave të parashikuara në ligjin për tarifën gjyqësore (pika 1); kur vendos pranimin e ankimit kushtetues individual, ajo mund të shprehet edhe për shpenzimet e përfaqësimit pjesërisht ose tërësisht, nëse kërkohet nga kërkuesi (pika 2). Kjo dispozitë është konkretizuar edhe në nenin 14 të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, sipas të cilit me paraqitjen e kërkesës paraqitet edhe akti që provon shlyerjen e tarifave përkatëse (pika 2); kur vendoset pranimi i ankimit kushtetues individual, Gjykata shprehet në dispozitiv edhe për shpenzimet e përfaqësimit dhe masën e tyre, nëse kjo kërkohet nga kërkuesi (pika 4). Gjykata vëren se referuar përmbajtjes së dispozitave si më sipër, së pari, disponimi për shpenzimet vihet në lëvizje vetëm me kërkesë formale nga ankuesi dhe, së dyti, një kërkesë e tillë mund të paraqitet së bashku me ankimin kushtetues individual deri kur deklarohet mbyllja e seancës plenare nga Gjykata. Në rastin konkret, kërkesa për shpenzimet gjyqësore është paraqitur përpara zhvillimit të seancës plenare.

62. Gjykata në jurisprndencën e saj ka theksuar se në parim çështja e shpenzimeve të përfaqësimit në gjykimin kushtetues të ankimit kushtetues individual është pjesë e procesit të rregullt ligjor dhe refuzimi për mbulimin e tyre rrezikon të kufizojë në mënyrë të pajustificuar të drejtën e individit për akses në gjykatë, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës. Individi ka të drejtën e mbulimit të shpenzimeve vetëm nëse vërteton se ato janë kryer, kanë qenë të nevojshme dhe në masë të arsyeshme, ndaj ai duhet të paraqesë edhe aktet që dokumentojnë në mënyrë reale dhe të nevojshme masën e shpenzimeve të kryera për qëllim të procesit kushtetues, të cilat në çdo rast duhet të jenë të arsyeshme dhe të shoqëruara me fatura tatimore të lëshuara sipas legjislacionit në fuqi. Sipas udhëzimit të përbashkët nr. 18, datë 5.8.2020, të ministrit të Drejtësisë dhe ministrit të Financave, “Për miratimin e kritereve të përfitimit të pagesave dhe tarifave të shpërblyerit të avokatëve që ofrojnë ndihmë juridike dytësore” (udhëzimi nr. 18/2020), shpenzimet për ofrimin e mbrojtjes juridike për përfaqësimin në Gjykatë përcaktohen në vlerat 50,000 lekë dhe 60,000 lekë, ndërsa për shërbime juridike jashtëgjyqësore përcaktohen në vlerat 25,000 lekë (përgatitje kërkesë) dhe 500 deri në 1,500 lekë ora (ofrimi i ndihmës juridike në formën e këshillimit – shih rubrikat I dhe II të shtojcës

1 “Tarifat e shërbimeve juridike të avokatëve të ndihmës juridike”). Nga ana tjetër, kriteret bazë për llogaritjen e masës lidhen me: kompleksitetin e çështjes, nivelin e formimit dhe përvojën juridike të kërkuesit për të kuptuar çështjen, moshën dhe gjendjen financiare të kërkuesit, si dhe elemente të tjera që ndikojnë në vlerën e kërkuar (*shih vendimet nr. 54, datë 9.10.2025; nr. 47, datë 18.9.2025, të Gjykatës Kushtetuese*).

63. Për sa i takon subjektit që ngarkohet për mbulimin e shpenzimeve të përfaqësimit, Gjykata ka theksuar se natyra dhe objekti i gjykimit kushtetues ndryshojnë nga gjykimi i zakonshëm, për sa kohë që në gjykimin kushtetues individ i kërkon të mbrojë të drejtat themelore të shkelura si pasojë e veprimtarisë së autoriteteve publike, ku përfshihet edhe ajo e gjykatave të zakonshme, që i kanë pasjellë atij cenimin e të drejtave themelore, ndaj përgjegjësia në këtë gjykim i takon vetë shtetit. Kjo logjikë ndiqet nga rregullimet ligjore për kompensimin e shkeljes të së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm, ku në gjykimin e zakonshëm thirren të paditur Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave (neni 399/4, pika 2, i KPC-së) (*shih vendimet nr. 54, datë 9.10.2025; nr. 47, datë 18.9.2025, të Gjykatës Kushtetuese*).

64. Për sa më sipër, Gjykata, duke pasur parasysh parashikimet e udhëzimit nr. 18/2020, aktet e përgatitura nga përfaqësuesja e kërkuesit për përfaqësimin e tij në këtë gjykim kushtetues, natyrën e çështjes konkrete, si dhe numrin e pretendimeve të pranuar, vlerëson se masa e arsyeshme për mbulimin e shpenzimeve gjyqësore në Gjykatë është në vlerën 75,000 lekë. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se kërkesa për shpenzimet e përfaqësimit është e drejtë dhe pranohet pjesërisht.

65. Në përfundim, Gjykata çmon se pretendimi i kërkuesit për cenimin e lirisë personale është i bazuar, sipas arsytimit të mësipërm, ndaj kërkesa pranohet pjesërisht.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, si dhe neneve 71 dhe 72 e vijuese të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Pranimin e pjesshëm të kërkesës.
2. Deklarimin si antikushtetuese të vendimeve nr. 400, datë 30.7.2024, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 172 (87-2024-248), datë 13.9.2024, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 00-2024-2076, datë 17.12.2024, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, sipas arsytimit të mësipërm të këtij vendimi, vetëm për pjesën që disponon për kërkuesin Sali Berisha.
3. Shpenzimet e përfaqësimit të kërkuesit në vlerën 75.000 lekë i ngarkohen Ministrisë së Financave.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 15.1.2026.

Shpallur më 3.3.2026.

Kryesuese: Marsida Xhaferllari

Anëtare pjesërisht kundër: Sonila Bejtja

Anëtarë: Fiona Papajorgji, Genti Ibrahim, Ilir Toska, Sandër Beci, Marjana Semini, Asim Vokshi

MENDIM PARALEL

1. Në shqyrtimin e çështjes që i përket kërkesës së kërkuesit Sali Berisha, me objekt: shfuqizimin e vendimeve nr. 400, datë 30.7.2024 të GJKKO-së së Shkallës së Parë; nr. 172 (87-2024-248), datë 13.9.2024 të GJKKO-së së Apelit; nr. 00-2024-2076, datë 17.12.2024, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, si dhe detyrimin e Ministrisë së Financave të rimbursojë shpenzimet e kryera deri në masën 200.000 lekë, unë, gjyqtarja Marjana Semini, ndonëse i jam bashkuar shumicës në qëndrimin e shprehur në dispozitivin e vendimit, kam qasje të ndryshme në lidhje me argumentet mbi të cilat është mbështetur ky qëndrim.

2. Referuar rrethanave të rastit konkret në shqyrtim, rezulton se kërkuesi i është drejtuar edhe më parë Gjykatës për kundërshtimin e vendimeve gjyqësore që kishin caktuar ndaj tij masat e sigurimit personal me karakter shtrëngues “*Detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore*” dhe “*Ndalimi i daljes jashtë shtetit*” (proces i parë), dhe në vijim edhe të vendimeve gjyqësore që kanë zëvendësuar ato masa sigurimi me “*Arresti në shtëpi*” (proces i dytë), për shkak se kërkuesi nuk kishte respektuar masën “*Detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore*”.

3. Në procesin e dytë kushtetues, në të cilin u vendos rrëzimi i kërkesës për shkak të mosarritjes së shumicës së kërkuar nga ligji, unë kam mbajtur qëndrimin se masa e sigurimit “*Arresti në shtëpi*” e caktuar ndaj kërkuesit nuk ka qenë proporcionale, në analizën e kushteve dhe kriterëve për zëvendësimin e masës së mëparshme me këtë masë më të rëndë, pasi kam vlerësuar se duhej të ishte analizuar nga gjykatat e zakonshme nëse ky zëvendësim ishte i nevojshëm, proporcional, i justifikuar, i përshtatshëm, si edhe nëse kjo masë rrezikonte të ishte më e ashpër kundrejt qëllimit të synuar. Në atë rast kam mbajtur qëndrimin se ndonëse kërkuesi ka dëshmuar mospërmbushje të detyrimit për zbatimin e masës së sigurimit “*Detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore*”, në analizë të nenit 231 të KPP-së qëllimi i kësaj norme është që të parashikojë zëvendësimin e kësaj mase me një tjetër më të rëndë si një mundësi, por në asnjë rast si një detyrim. Një qëndrim i ndryshëm, në vlerësimin tim, nuk rezulton as nga shkronja dhe as nga fryma e kësaj norme.

4. Në vijim, po në atë proces kam vlerësuar se ndonëse në pamje të parë dhe teorikisht zëvendësimi i masës është kryer në mbështetje të nenit 228 të KPP-së, përsëri gjykatat e posaçme, për të konkluduar për përshtatshmërinë dhe proporcionalitetin, duhet të analizojnë edhe ndikimin e rrethanave të rastit konkret për mirëfunksionimin e demokracisë në vend dhe mirëfunksionimin e pluralizmit politik. Ndonëse në procesin e parë (vendimi nr. 81/2024) Gjykata ka mbajtur qëndrimin se masa e sigurimit “*Detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore*” është proporcionale në drejtim të përshtatshmërisë, unë kam vlerësuar se përshkallëzimi në drejtim të masës “*Arresti në shtëpi*” ka rënduar pozitën e kërkuesit, duke e “penalizuar” atë në një mënyrë më të ashpër sesa do të ishte e justifikuar, e arsyeshme, e përshtatshme dhe e nevojshme (shih vendimin nr. 1, datë 17.1.2025, të Gjykatës Kushtetuese, paragrafi 108).

5. Për rrjedhojë, edhe në rastin konkret, në të njëjtën linjë arsyetimi, parashtroj qëndrimin tim se vijimi i masës personale kufizuese të lirisë “*Arresti në shtëpi*” nuk respekton parimin e proporcionalitetit të ndërhyrjes në drejtim të ashpërsisë së saj, për sa kohë ajo u vendos në

formën e një sanksioni për shkak të mospërbushjes së detyrimit për ekzekutimin e masës së sigurimit “*Detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore*”. Për rrjedhojë, në këtë logjikë juridike kjo masë rënduese, me qëllimin në vetvete të “ndëshkimit” për mospërbushjen e detyrimit ligjor të parashikuar nga neni 234 i KPP-së, nuk mund të zgjasë për një periudhë të pacaktuar kohore, sepse në këtë mënyrë e humbet qëllimin e vendosjes së saj dhe qëllimin e vetë normës që e parashikon atë. Në këtë kuptim, në kushtet që kam vlerësuar se masa e sigurimit “*Arresti në shtëpi*”, e caktuar ndaj kërkuesit vetëm për shkak të mosrespektimit të masës tjetër “*Detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore*”, ka qenë jokushtetuese që në momentin që është caktuar për herë të parë, edhe vijimi i kësaj mase është për njëjtat shkaqe jokushtetues.

6. Në vijim të linjës së mësipërme arsyetoj se, për sa kohë që në momentin e caktimit të masës së sigurimit “*Arresti në shtëpi*” ndaj kërkuesit nuk është verifikuar ekzistenca e ndonjërit nga kushtet për justifikimin e kufizimit të lirisë, aq më tepër nuk ekziston nevoja e vijimit të së njëjtës masë siguri në kushtet e paraqitjes së raportimit dymujor nga prokuroria. Në rastin në shqyrtim, nga gjykatat duhet të ishte vlerësuar nga e para shfaqja e ndonjërit nga rreziqet e mundshëm për mundësinë e largimit të kërkuesit, të helmimit të provave ose çfarëdolloj ndikimi tjetër në procesin gjyqësor që lidhet me to në mënyrë që të mund të justifikoheshin tashmë nevoja për vijimin e një masë të rëndë ndaj kërkuesit. Në këtë kuptim, vendimeve objekt kërkese, për sa kohë u mungon një analizë për ekzistencën e këtyre kushteve, konsiderohet se u mungon arsyetimi i mjaftueshëm për nevojën dhe proporcionalitetin e masës personale të caktuar ndaj kërkuesit.

7. Për sa më sipër, shkaqet e dhëna nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm nuk janë të “*mjaftueshme*” për të justifikuar vijimin e mbajtjes së kërkuesit nën masën “*Arresti në shtëpi*”. Gjithashtu, dëshiroj të theksoj se vijimi i kufizimit të lirisë personale kërkon një kontroll rigoroz, të përditësuar dhe të individualizuar të rrethanave konkrete të çështjes, përtej referimit formal në shkaqet fillestare, në përputhje edhe me jurisprudencën e GJEDNJ-së për nenin 5 të Konventës (*shih vendimin Gjellçi kundër Shqipërisë, datë 25.2.2025*), që ka theksuar se gjykatat duhet të specifikojnë se cilat ishin provat specifike që mund të manipuloheshin ose helmoheshin, të cilat duhej të mbledheshin akoma, si edhe duhet të shpjegojnë pse ato prova nuk mund të merreshin në një fazë më të hershme të hetimit, gjë që nuk rezulton të jetë kryer në rastin konkret nga gjykatat e zakonshme.

Anëtare: Marjana Semini

MENDIM PARALEL

1. Në shqyrtimin e çështjes që i përket kërkesës së kërkuesit Sali Berisha, me objekt: shfuqizimin e vendimeve nr. 400, datë 30.7.2024 të GJKKO-së së Shkallës së Parë; nr. 172 (87-2024-248), datë 13.9.2024 të GJKKO-së së Apelit; nr. 00-2024-2076, datë 17.12.2024, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, si dhe detyrimin e Ministrisë së Financave të rimbursojë shpenzimet e kryera deri në masën 200.000 lekë, unë, gjyqtari Asim Vokshi, ndonëse jam dakord me dispozitivin e vendimit, ndjek një optikë tjetër për arsyetimin e tij, për aspektet që vijnë.

2. Vendimet objekt kundërshtimi kushtetues nga ana e kërkuesit lidhen me vendimmarrjen e gjykatave të zakonshme për vijimin e zbatimit të masës shtrënguese të sigurimit “*Arresti në shtëpi*”, të parashikuar nga neni 237 i KPP-së, të caktuar ndaj tij rreth 7 muaj më herët, për shkak të moszbatimit nga ana e kërkuesit të masës shtrënguese të sigurimit “*Detyrimi për t’u paraqitur në Policinë Gjyqësore*”, të parashikuar nga neni 234 i KPP-së, pasi ai pretendonte se kjo masë ishte antikushtetuese, për shkak të mosmarrjes së autorizimit nga Kuvendi për vendosjen e saj, sipas përcaktimeve të nenit 73, pika 2, të Kushtetutës.

3. Ndonëse ndaj një optikë tjetër me jurisprudencën e deritanishme të Gjykatës për interpretimin e shprehjes “t’i hiqet liria në çfarëdo formë”, sipas nenit 73, pika 2, të Kushtetutës, jam i vetëdijshëm se për këtë rast konkret që lidhet me kërkuesin, Gjykata e ka thënë fjalën e vet për masën e sigurimit “Detyrimi për t’u paraqitur në Policinë Gjyqësore”, nëpërmjet vendimit nr. 81/2024, e kësajose e respektoj këtë vendimmarrje të mëparshme dhe e gjej të pavend që të ndalem më tej në elaborimin e këtij koncepti kushtetues. Po kështu, Gjykata e ka thënë fjalën e vet edhe për kushtetutshmërinë e procesit dhe vendimmarrjeve të gjykatave të zakonshme për zëvendësimin e masës së sigurimit “Detyrimi për t’u paraqitur në Policinë Gjyqësore” me masën “Arresti në shtëpi”. Ndaj nuk do të ndalem më tej edhe në trajtimin e aspekteve kushtetuese që lidhen me këtë fazë të ecurisë së caktimit dhe të zbatimit të masave të sigurisë personale ndaj kërkuesit, por e marr të mirëqenë zgjidhjen e dhënë me vendimin nr. 1/2025 të Gjykatës.

4. Referuar jurisprudencës së GJEDNJ-së në çështjet *Buzadji kundër Republikës së Moldavisë* (aplikimi nr. 23755/07, datë 5 korrik 2016) dhe atë *Gëllçit kundër Shqipërisë* (aplikimi nr. 15468/23, datë 25 shkurt 2025), vlerësoj se ato duhen lexuar nën dritën e rrethanave konkrete të atyre rasteve dhe se rrjedhimisht nuk mund të aplikohen plotësisht për rrethanat e rastit objekt shqyrtimi kushtetues. Kjo, pasi GJEDNJ-ja si gjykatë ndërkombëtare, në zbatim të standardeve të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), e vendos fokusin te rasti konkret objekt shqyrtimi dhe përfundimet e saj lidhen shumë me ato rrethana konkrete.

5. Vlerësoj se konceptet kushtetuese që mbartin nenet 27 e 28 të Kushtetutës, të para në lidhje me nenin 5 të KEDNJ-së, duhen analizuar nën dritën e rrethanave konkrete të secilit rast, në mënyrë që të garantohet respektimi i standardeve kushtetuese e konventore në mbrojtje të lirisë së shtetasve. Kësajose, për sa u përket masave të sigurimit personal që kufizojnë lirinë personale (përfshirë edhe lirinë e lëvizjes), në përgjithësi mund të thuhet se shtrohen dy mundësi vlerësimi për Gjykatën: 1) nëse normat e ligjit procedural (KPP-së) janë ose jo në përputhje me parashikimet kushtetuese e konventore; 2) nëse zbatimi i normave është bërë në përputhje me standardet kushtetuese e konventore. Rasti i parë nuk gjen zbatim në këtë çështje, pasi normat procedurale penale nuk janë goditur për antikushtetutshmëri, por, si të tilla, janë kundërshtuar vendimet e gjykatave të zakonshme për vijimin e zbatimit të masës së sigurimit “Arresti në shtëpi”. Pra, shtrohet për zgjidhje nëse zbatimi i ligjit në rastin e vendimmarrjeve për vijimin e zbatimit të masës së sigurimit personal “Arresti në shtëpi” është bërë ose jo në pajtim me standardet kushtetuese e konventore.

6. Për sa më sipër, siç ka pohuar edhe më parë Gjykata, çdo masë që kufizon liritë dhe të drejtat e individit duhet të jetë në përputhje me ligjin, të ndjekë një qëllim legjitim dhe të respektojë një ekuilibër të drejtë midis interesit publik dhe të drejtave e lirive të tij. Një ndërhyrje do të konsiderohet “e nevojshme në një shoqëri demokratike” për një qëllim të ligjshëm nëse i përgjigjet një “nevoje sociale urgjente” dhe, në veçanti, nëse është proporcionale me qëllimin legjitim të ndjekur, dhe nëse arsyet e gjykatave për ta justifikuar atë janë “relevante dhe të mjaftueshme”. Testi i proporcionalitetit të ndërhyrjes kërkon që masa të jetë e përshtatshme për të arritur funksionin mbrojtës. Me fjalë të tjera, një kufizim është i justifikueshëm vetëm për atë që ai ndihmon në arritjen e qëllimit legjitim të synuar. Vlerësimi i proporcionalitetit të ndërhyrjes bazohet në tri shtylla kryesore: justifikimi i kufizimit nën dritën e funksionit të tij mbrojtës; cilësia e vlerësimit të brendshëm; ashpërsia e kufizimit (*shih vendimin nr. 81, datë 21.11.2024, të Gjykatës Kushtetuese*). Në lidhje me rastin konkret objekt shqyrtimi, rëndësi merr vlerësimi i kriterëve: i. justifikimi i kufizimit nën dritën e funksionit të tij mbrojtës; ii. ashpërsia e kufizimit në kuadër të kohëzgjatjes së tij.

7. KPP-ja në nenin 231 të saj ka përcaktuar qartë kriteret për zëvendësimin e masave të sigurimit në rast të shkeljeve nga personi ndaj të cilit janë caktuar ato, të detyrimeve që lidhen me zbatimin e tyre. Konkretisht, kjo dispozitë parashikon, se: “1. Në rast shkeljeje të

detyrimeve që lidhen me një masë sigurimi, gjykata mund të vendosë zëvendësimin ose bashkimin me një masë tjetër më të rëndë, duke mbajtur parasysh rëndësinë, motivet dhe rrethanat e shkeljes. Për shkeljen e detyrimeve që lidhen me një masë ndaluese, gjykata mund të vendosë zëvendësimin ose bashkimin me një masë shtrënguese.”. Sipas kësaj dispozite paraqiten me rëndësi për vlerësimin e rëndimit të nevojave të sigurimit: i. rëndësia e shkeljes së masës së mëparshme shtrënguese të sigurimit; ii. motivet se përse nuk u respektua ajo masë; iii. rrethanat e shkeljes së detyrimeve sipas masës së mëparshme. Ndonëse Gjykata ka rrëzuar më parë kërkesën e kërkuarit për antikushtetutshmërinë e zëvendësimit të masës së sigurimit personal nga “Detyrimi për t’u paraqitur në Policinë Gjyqësore” në atë të “Arresti në shtëpi”, vlerësoj se motivet e mosrespektimit të masës së sigurimit “Detyrimi për t’u paraqitur në Policinë Gjyqësore”, duhet të ishin vlerësuar me kujdes nga gjykatat e zakonshme në drejtim të “ashpërsisë” së vijimit të masës së sigurimit “Arresti në shtëpi” edhe 7 muaj pas caktimit të saj me zëvendësim. Kjo, pasi masa e sigurimit në fjalë përbën kufizim të lirisë personale të kërkuarit dhe, si e tillë, kërkohet që të ndjekë një qëllim legjitim, të jetë e përshtatshme dhe e domosdoshme për arritjen e këtij qëllimi, si dhe të ruajë një ekuilibër të drejtë ndërmjet interesit publik dhe kufizimit të së drejtës së individit.

8. Në parim vlerësoj se, kur gjykatat kanë caktuar një masë shtrënguese të sigurimit personal më të lehtë se ajo “Arresti në shtëpi” dhe personi ndaj të cilit është caktuar masa në fjalë nuk e respekton atë tërësisht (kriteri i rëndësisë), pa pasur motive të justifikuara (kriteri i motiveve të arsyeshme) dhe pa pasur rrethana që t’i pamundësonin objektivisht zbatimin e masës (kriteri i rrethanave të shkeljes), atëherë gjykatat nuk kanë ndalim që kushtet dhe kriteret për caktimin e masës më të lehtë t’ia aplikojnë një mase sigurimi më të rëndë, siç është edhe “Arresti në shtëpi”, sipas nenit 237 të KPP-së. Zbatimi i masave të sigurimit personal nuk është çështje që lihet në vullnetin e personit, por ato janë të tilla që kufizojnë vullnetin e personit për t’i zbatuar ose jo ato. Kur gjykata cakton një masë sigurimi ajo duhet zbatuar edhe sikur personi të mendojë se ajo është e padrejtë ose e pajustificuar, pasi këto pretendime ai i adreson vetëm nëpërmjet mjeteve të ankimit, ku *ultima ratio* është edhe ankimi kushtetues individual. Mirëpo, në rastin konkret, objekt shqyrtimi, qëndrimi moszbatues nga kërkuari për masën e sigurimit personal “Detyrimi për t’u paraqitur në Policinë Gjyqësore” ka qenë i bazuar jo vetëm në leximin e tij të nenit 73, pika 2, të Kushtetutës, por siç ka konstatuar edhe vetë Gjykata në paragrafin 55 të vendimit nr. 81/2024, edhe në faktin e precedentëve të vendimmarrjeve të Kuvendit ku është theksuar, se: “në rastin e deputetit të shumicës parlamentare S.T., [...] Kuvendi, i vënë në lëvizje me kërkesën e prokurorisë për dhënien e autorizimit për arrestimin ose heqjen e lirisë, si dhe kontrollit personal dhe të banesës së atij deputeti, me vendimin nr. 104/2017, datë 25.10.2017, ka vendosur: pranimin e kërkesës për dhënien e autorizimit për kontrollin personal dhe të banesës; dhënien e autorizimit për ndalimin e daljes jashtë shtetit, detyrimin për t’u paraqitur në Policinë Gjyqësore; ndalimin dhe detyrimin për të qëndruar në një vend të caktuar si masë shtrënguese të heqjes së lirisë, në kuptim të shkronjave “a”, “b” dhe “c” të nenit 232 të KPP-së; rrëzimin e kërkesës për dhënien e autorizimit për masën e arrestit në burg ose në shtëpi për deputetin, në kuptim të shkronjave “d” dhe “dh” të nenit 232 të po këtij kodi.”

9. Duke qenë se motivet e moszbatimit të masës së sigurimit personal “Detyrimi për t’u paraqitur në Policinë Gjyqësore” prej kërkuarit nuk ishin arbitrare ose haptazi të pabazuara, vlerësoj se ky fakt duhej mbajtur parasysh nga gjykatat e zakonshme në drejtim të vlerësimit si joproporcional të vijimit edhe pas 7 muajve të masës së sigurimit personal “Arresti në shtëpi”. Pra, jo se vijimi i masës “Arresti në shtëpi” kërkonte ndonjë arsye ose rrethanë më shumë sesa ato që ekzistonin kur u caktua fillimisht masa “Detyrimi për t’u paraqitur në Policinë Gjyqësore” (e zëvendësuar për shkak të moszbatimit të masës së parë të sigurimit), por kohëzgjatja e masës (rreth 7 muaj) së bashku me arsyen e caktimit të saj si masë zëvendësuese dhe motivet me natyrë kushtetuese (jo haptazi të pabazuara) të kërkuarit për

refuzimin e masës së sigurimit “Detyrimi për t’u paraqitur në Policinë Gjyqësore”, bëjnë që vijimi i zbatimit të masës “Arresti në shtëpi” të vlerësohet antikushtetues, për shkak të të qenit joproporcional.

10. Në dallim nga shumica vlerësoj se, si rregull, ndonëse prokuroria dhe gjykatat vlerësojnë fillimisht se nevojat e sigurimit (marrja ose vërtetësia e provave) plotësohen nga masa “Detyrimi për t’u paraqitur në Policinë Gjyqësore”, kur personi nën hetim e shkel këtë masë dhe rëndësia, motivet ose rrethanat e shkeljes passjellin rëndimin e nevojave të sigurisë, atëherë kushtet dhe kriteret që justifikonin masën më të lehtë do të vlerësohet se i përshtaten tashmë masës më të rëndë, e cila, për shkak të sjelljes së personin nën hetim, është tashmë masa më e përshtatshme për garantimin e nevojave të sigurimit. Kur nevojat e sigurimit zgjasin në kohë ose mbeten të njëjta me ato të fillimit, kjo e justifikon mbajtjen e masës më të rëndë të sigurimit, për sa kohë që rreziku i helmimit të provave vijon të ekzistojë dhe organi procedues po e ushtron detyrën e vet me shpejtësi dhe kujdes të shtuar e të vazhdueshëm (diligjencë). Në dallim nga shumica vlerësoj se rrethana e moszbatimit të masës më të lehtë të sigurimit, kur passjell rëndimin e nevojave të sigurimit, përbën rrethanë të mjaftueshme për vijimin e zbatimit të masës më të rëndë të sigurimit, me kusht që nevojat e sigurimit të mbeten ose të pandryshuara, ose të rëndohen më tepër. Kërkesa për arsye të reja që të justifikojnë vijimin e një mase sigurimi nuk mund të kthehet në një kërkesë abstrakte, të cilën asnjë gjyqtar nuk është në gjendje ta përkthejë në terma realë. Kalimi i kohës në zbatimin e një mase sigurimi me karakter shtrëngues merr rëndësi në drejtim të zbutjes së nevojave të sigurimit, vetëm kur masa e sigurimit është caktuar për garantimin vetëm të kriterit të përcaktuar nga neni 228, pika 3, shkronja “a”, i KPP-së (ekzistenca e rrezikut për marrjen ose vërtetësinë e provës) dhe njëkohësisht organi procedues ka proceduar me sigurimin e provave të nevojshme, dhe rreziku i dëmtimit të provave me dëshmitarë është i zbehtë. Gjykatat e zakonshme kanë detyrimin të mbajnë parasysh për sa më sipër, veçanërisht kur masa e sigurimit caktohet vetëm për kriterin e përcaktuar në nenin 228, pika 3, shkronja “a”, të KPP-së, ku duhet të tregojnë posaçërisht “rrethanat e faktit” që justifikojnë vendosjen ose vijimin e mbajtjes së masës së sigurimit personal.

11. Vendimet objekt ankimi kushtetues individual nuk janë të paarsyetuara për sa më sipër, pasi gjykatat kanë renditur veprimet hetimore të kryera dhe ato që vijonin (*duke mbetur nevojat e sigurimit mjaftueshmërisht të pandryshuara, në raport me kushtet për caktimin e masave shtrënguese të sigurimit*) dhe në parim gjyqtari i hetimit paraprak është në pozitë më të mirë se Gjykata për vlerësimin e nevojave të sigurimit për një procedurë hetimore dinamike në zhvillim e sipër. Por, siç parashtrova edhe më lart, elementi me rëndësi në aspektin kushtetues që më krijon bindjen për mungesën e proporcionalitetit të vijimit të masës së sigurimit personal “Arresti në shtëpi” për kërkuesin nuk është mungesa e kushteve për zbatimin e një mase sigurimi sipas nenit 228, pika 3, shkronja “a”, të KPP-së (*vlerësimin e fakteve e bëjnë gjykatat e zakonshme dhe Gjykata Kushtetuese duhet të jetë e kufizuar në këtë drejtim*), por rrethanat që lidhen me motivet e tij për moszbatimin e masës fillestare të sigurimit, të cilat, siç kam theksuar edhe më lart, nuk ishin haptazi të pabazuara. Justifikimi që ka shërbyer për rëndimin e masës së sigurimit ndaj kërkuesit, nën dritën e nenit 231 të KPP-së nuk i përshtatej izolimit më shumë se 7-mujor në shtëpi të kërkuesit, për sa kohë që, sipas vlerësimit fillestar të gjykatave një masë sigurimi më e lehtë e përmbushte të njëjtën nevojë sigurimi (garantimin e marrjes ose të vërtetësisë së provave). Ndaj jam dakord me zgjidhjen, por dalloj në lidhje me arsyet se përse e konsideroj joproporcional, domethënë që nuk i përshtatet rëndësisë së fakteve që çuan në vendosjen e masës zëvendësuese, rrjedhimisht jo në pajtim me Kushtetutën, vendimmarrjen e gjykatave të zakonshme për vijimin e masës së sigurimit personal “Arresti në shtëpi” edhe 7 muaj pas caktimit fillestar të saj. Në fund të fundit, siç parashikon fjalia e fundit e nenit 17, pika 1, të Kushtetutës, “kufizimi duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë”, çka do të thotë se rëndësia e shkeljes së një mase sigurimi, motivet dhe rrethanat e kryerjes së

kësaj shkeljeje, duhen mbajtur parasysh nga gjykatat jo vetëm në momentin kur zëvendësojnë një masë sigurimi me karakter shtrëngues me një më të rëndë, por edhe kur vendosin periodikisht vazhdimin e saj ndaj personit nën hetim ose të pandehurit.

Anëtar: Asim Vokshi

MENDIM PJESËRISHT KUNDËR

1. Në shqyrtimin e çështjes konkrete, me objekt shfuqizimin e vendimeve nr. 400, datë 30.7.2024 të GJKKO-së së Shkallës së Parë; nr. 172 (87-2024-248), datë 13.9.2024 të GJKKO-së së Apelit; nr. 00-2024-2076, datë 17.12.2024, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën, si dhe detyrimin e Ministrisë së Financave të rimbursojë shpenzimet e kryera deri në masën 200.000 lekë, unë, gjyqtarja Sonila Bejtja, ndonëse jam dakord me qëndrimin e shumicës për deklarimin si antikushtetuese të vendimeve të kundërshtuara, mbaj qëndrimin se këto vendime duhej edhe të shfuqizoheshin.

2. Në rastin në shqyrtim, vendimet objekt i këtij gjykimi kushtetues kanë disponuar vijimin e zbatimit të masës shtrënguese të sigurimit “Arresti në shtëpi”, bazuar në kërkesën e Prokurorisë së Posaçme, sipas nenit 246, pika 6, të KPP-së. Kjo masë sigurimi (Arresti në shtëpi) është vendosur ndaj kërkuesit në procesin e dytë, për shkak se ai nuk kishte respektuar një nga masat e sigurimit të vendosura më parë ndaj tij në procesin e parë, konkretisht për moszbatimin e masës së sigurimit “Detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”. Të dyja këto procese (procesin e parë dhe procesin e dytë) janë bërë objekt i vlerësimit nga Gjykata me vendimet nr. 81/2024 (procesin e parë) dhe nr. 1/2025 (procesin e dytë).

3. Për sa u përket këtyre proceseve, unë gjyqtarja Sonila Bejtja, në procesin e parë ku ndaj kërkuesit ishin vendosur dy masa sigurimi, konkretisht “Detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore” dhe “Ndalimi i daljes jashtë shtetit”, ndonëse për masën e parë (Detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore) kam vlerësuar se nuk ishte e detyrueshme marrja e autorizimit nga Kuvendi, për masën e dytë (Ndalimi i daljes jashtë shtetit) kam çmuar se ajo ka ndërhyrë në liritë kushtetuese vetjake të kërkuesit në atë masë që kërkonte respektimin e detyrimit të përcaktuar nga neni 73, pika 2, i Kushtetutës, pra marrjen e autorizimit nga Kuvendi. Për këtë arsye, në atë rast kam vlerësuar se mosrespektimi i kësaj kërkeje e bën tërësisht jokushtetuese të gjithë procedurën e ndjekur nga Prokuroria e Posaçme, për pasojë edhe vendimmarrjen e gjykatave që e kanë vlerësuar të ligjshme atë (*shih mendimin e pakicës në vendimin nr. 81/2024 të Gjykatës*).

4. Për sa i përket procesit të dytë, ku janë zëvendësuar masat e sigurimit ndaj kërkuesit, duke iu caktuar masa e sigurimit “Arresti në shtëpi”, unë kam mbajtur qëndrimin se për sa kohë vendimi që ka caktuar masën e sigurimit, e cila nuk është zbatuar nga kërkuesi, dhe që ka sjellë edhe zëvendësimin e masave të vendosura më parë ndaj tij me një masë më të ashpër të sigurimit personal, konkretisht “Arresti në shtëpi”, është marrë mbi një procedurë jokushtetuese, ai vendim, që caktonte ato masa, nuk mund të sillte asnjë pasojë, për rrjedhojë edhe ato nuk mund të sillnin asnjë pasojë ndaj lirisë personale të kërkuesit. Në këtë drejtim, në atë rast kam vlerësuar se mosrespektimi i procedurës parlamentare për shkak të mosmarrjes së autorizimit nga Kuvendi, si një kërkesë kushtetuese, shkelja e së cilës ka vesuar të gjithë procesin për caktimin e masave kufizuese të lirisë, sjell pasoja të drejtpërdrejta edhe në procesin e zëvendësimit të atyre masave, duke e vesuar edhe atë proces nga pikëpamja kushtetuese (*shih qëndrimin e shprehur me footnote në vendimin nr. 1/2025 të Gjykatës, faqe 30*).

5. Për sa më lart, në vijim edhe të të njëjtit qëndrim të mbajtur më parë prej meje si më sipër, si dhe duke qenë se vendimet objekt i këtij gjykimi kushtetues janë të lidhura ngushtësisht me vendimet e bëra më parë objekt gjykimi nga Gjykata, për të cilat kjo e fundit ka disponuar me vendimet nr. 81/2024 dhe nr. 1/2025, për sa kohë masat e sigurimit “Ndalimi i daljes jashtë

shtetit” dhe “Detyrimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”, të vendosura fillimisht ndaj kërkuesit në procesin e parë janë marrë bazuar në një procedurë jokushtetuese dhe për pasojë edhe zëvendësimi i tyre me një masë më të ashpër, siç është “Arresti në shtëpi”, është marrë po bazuar në një procedurë jokushtetuese, jam e mendimit se edhe në rastin konkret vendimet gjyqësore që kanë disponuar për vijimin e zbatimit të masës së sigurimit “Arresti në shtëpi” janë antikushtetuese dhe nuk mund të sjellin asnjë pasojë ndaj kërkuesit.

6. Për rrjedhojë, ndonëse jam dakord me vlerësimin e shumicës për deklarimin si antikushtetuese të vendimeve të kundërshtuara, çmoj gjithashtu se vendimet objekt i këtij gjykimi kushtetues, të cilat kanë disponuar vijimin e zbatimit të masës shtrënguese të sigurimit “Arresti në shtëpi”, bazuar në kërkesën e Prokurorisë së Posaçme, duhej edhe të shfuqizoheshin nga Gjykata, pasi vijnë në kundërshtim me Kushtetutën.

Anëtare: Sonila Bejtja